Shaban Çupi



GAFURR LOKU

(1949 - 1999)

Monografi dokumentare

SHABAN ÇUPI

GAFURR LOKU
(1949 - 1999)
MONOGRAFI DOKUMENTARE



Redaktor
Fadil Curri

Recensues
Emrush Dernjani

Lektor
Mehmet Ballazhi

Korrektor
Shaban Çupi

Sponsor: "Salloniti" Hani i Elezit

SHABAN ÇUPI

GAFURR LOKU
(1949 - 1999)
MONOGRAFI DOKUMENTARE

HANI I ELEZIT
2003

NË VEND TË PARATHËNIES

Të shkruash për veprën atdhetare të dëshmorit Gafurr Loku, vërtetë është përgjegjësi e veçantë. Dimensioni i veprimtarisë së tij nuk ishte lokal dhe të përthëkohet lehtë, përkundrazi Gafurr Loku kishte një gamë të gjërë veprimtarie dhe kontakte me shumë veprimtarë, andaj në rrjedhë të kësaj, kam vetëdijen e plotë se aktiviteti atdhetar i dëshmorit nuk ka mundur të përfshihet në tërësi. Megjithatë, përpjekja për të shkruar për Gafurr Lokun më tepër i gjason një rekuiemi në katër vjetorin e vrasjes dhe në anën tjetër, një cytje për shokët e tij të burgut dhe veprimtarisë ilegale që ta plotësojnë me shkrime veprën e Gafurr Lokut.

Gafurr Loku kishte një jetë të shkurtër. Tërë jetën që kishte ia fali çlirimit të atdheut. E donte të jetojë i lirë shqiptari plisbardhë. Në anën tjetër, kishte një urrejtje të madhe për pushtuesin që i kishte shkelur vatanin, andaj tërë jetën e luftoi.

Kokëfortësisë kombëtare të Gafurrit, pushtuesi iu përgjigj me një ndjekje të përhershme, duke filluar që nga mosha e tij e re, pra që nga viti 1968, kur Gafurri në Tetovë shpalosi flamurin kuq e zi e deri më 21 shkurt të vitit 1999 kur edhe e vranë bashkë me djalin e tij njëzetvjeçarë, Dritonin.

Burgosjet dy herë radhazi dhe dënimi me tetë vite e gjysmë burg si dhe torturat e tmerrshme

nëpër kthinat e UDB-së sllave, kishin një qëllim të përbashkët, ta thyejnë të pathyerin e Tetovës, flamurin e Kosovës. Nuk mundën. "E vranë, por s'e shtrinë". Mirë e thot poeti.

Me Gafurrin kemi kaluar çaste të këndshme nga jeta jonë. Kemi qenë intim ndaj njëri-tjetrit. Me njerëzit ishte i afërt dhe popullorë. Respektonte çdo njeri. Edhe guri gdhendet-thoshte. Në rrjedhë të kësaj, kishte një autoritet të pazëvendësueshëm në rreth. Këtë e dinte UDB-a sllave, andaj edhe atentati u organizua pikërisht ndaj tij.

Para dhe gjatë luftës në Kosovë, atdheun tonë e vërsulën falanga të ndryshme kriminale serbe duke filluar nga KOS-i ushtarak, Sigurimi Shtetror, MUP-i, "Beretat e kuqe", Njësitë Frenkiste, Tigrat, sheshelistët, drashkoviqët dhe organizata paramilitare serbe "Dora e Zezë" e cila ka ekzekutuar shumë atdhetarë. Nga dora e saj është vrarë edhe Gafurr Loku me të birin e tij Dritonin.

Monografinë dokumentare "Gafurr Loku 1949-1999" e shkruan duke u mbështetur në dokumentet e tij që mbijetuan kohën dhe nëpërmjet tyre, deshëm ta "arkivojmë" lëndën e tij, me shpresë se në të ardhmen këto shënime do të shërbejnë për brezat e rinjë për të kuptuar dhe për t'mos harruar rrugën nëpër të cilën kaloi populli shqiptarë.

15 dhjetor 2002, Paldenicë
AUTORI

"ME TRUP NË TETOVË, SHPIRTIN
NË PRISHTINË TË VRANË GAFURR LOKU,
S'TË SHTRINË"

FADIL CURRI

LINDJA E DËSHMORIT

Një natë gushti të vitit 1949, shtëpia e Xhafer Lokut në fshatin Kotlinë[1] të Kaçanikut po shtohej për një anëtarë. Nënë Rabishes po i afrohej

---

1. Edhe pse për Kotlinën janë shfaqur mendime se është toponim sllav, ne mendojmë ndryshe, duke u mbështetur në etimologji shqipe. Ky toponim kujtojmë se është formim me mjete të shqipes, nga Ka-tlinë. Pjesa e dytë mund të ketë edhe kuptimin e tlyenit, sepse të folmes kotlinase i mungon fonema y dhe shqiptohet me i, tlinë, por edhe tlinë veshje e poshtme e lehtë, mirëpo kjo fjalë i mungon leksikut të kësaj të folmeje. Kujtojmë me apofonizim a-së në o, prej Ka- në Ko- dhe emri tlinë-Kotlinë-a. (Ramadan Asllani, Avdyl Dura me bashkëluftëtarë për Shqipërinë etnike" faqe 269.

Zenel Lala është një personalitet i njohur i Kotlinës, por i pastudiuar... Zenel Lalën e kishin varur në Prizren për shkak se e kishte bërë një vrasje në fshatin Vratnicë. Për këtë akt, si dënohet duke u dërguar në burgun e Nishit. Sa kishte qenë atje e kishte vizituar motra. Kada e veshur me rroba kombëtare dhe e qethur për t'u dukur si mashkull, për shkak se nuk kishte kush ta vizitonte, e paraqitur në cilësinë e vëllait. (Po aty faqe 271-272).

Man Kotlina, bir i Beqir Lokut, i fshatit Kotlinë të Kaçanikut, jetim. Këtij, Hasani (Budakova, vër. e Sh.Ç.) i ndërtoi shtëpi dhe e martoi. Ai ishte roje besnike e Hasan Hysenit. (Mr. Sheremet Krasniqi "Hasan Hysen Budakova" faqe 77.

Në fshatin Kotlinë në veri të Puseve të Nikës, në vendin e quajtur te "Kalaja", prone e Safet Ramush Lokut, Avni Kuçi ka zbuluar një pllakë-altar me mbishkrimin që i kushtohet perëndisë romake, Jupiter. Altari ka formën e kubit, me një lartësi prej 85 cm; trashësia e saj është 31 cm. Brenda kornizave (48cm-30 cm) janë skalitur shkronjat në gjuhën latine. Ky mbishkrim është i dëmtuar dhe i mungon një pjesë e fundit e anës së djathtë, kurse i përket vitit 227 (shek. III e.s.) (Emrush Dernjani "Hani i Elezit me rrethinë" faqe 16).

24.3.1999. Rifilluan granatimet në fshatin Puset e Nikës dhe fshatra tjerë të Kaçanikut. U djegën disa shtëpi të fshatrave Bushë të Epërm dhe Dacë. Po këtë ditë bëhet masakra (nga ana e serbëve, vër. Sh.Ç.) në fshatin Kotlinë. Masakrohen 23 fshatarë. (Rufki Suma, Ushtria Çlirimtare e Kosovës në trevën e Hanit të Elezit" faqe 30.

edhe një krah pune. Kosovës së sfilitur nga lufta, skamja, "otkupi"..., i lindi një luftëtarë, i cili tërë jetën që po ia dhuronte Zoti, do ta shpenzonte për lirinë e popullit të tij. Pra, një natë gushti gjegjësisht me 11.8.1949 u lind biri i Kosovës Gafurr Loku.

Gafurr Loku lindi një muaj e gjysmë pasi u vranë tribunët e trevës së Kaçanikut Avdyl Dura dhe Ramë Beka si një ogur i mirë se Lëvizja Kombëtare për çlirimin e Kosovës do të vazhdojë dhe regjimi i ri sllavokomunist që e nëpërkëmbi lirinë e Kosovës, vazhdimisht do të ndeshet me tribunë të tjerë.

Gafurri rritej maleve dhe fushave të Kotlinës, tek këmbët e Sharrit plak me lojrat fëmijërore të kohës. Kur i mbushi shtatë vite u regjistrua në klasën e parë me synime shumë të mëdha që në të ardhmen të bëhet një mësues, profesor, inxhinjerë apo ekonomist i mirë, sepse analfabetizmi e kishte shkallmuar shqiptarin po aq sa robëria e shkaut.

Ciklin e ulët të fillores e kreu në vendlindje, por meqë Xhafer Loku bleu një shtëpi në Lagjen e Demzenëve në Paldenicë, pjesën tjetër të fillores e kreu në Han të Elezit, ku pas përfundimit të saj, shpërngulet në Tetovë dhe Gafurr Loku do të regjistrohet në gjimnazin e Tetovës dhe atje do të gjejë rrethin e shokëve të ri me të cilët do të bashkëveprojë deri në fund të jetës së tij.

Në gjimnazin e Tetovës, Gafurri filloi të lexojë me ëndje letërsinë shqipe. Romanet e lejuara dhe të ndaluara e nxitën edhe më shumë të

merret me çështjen shqiptare. E kuptoi thellë se populli shqiptar u coptua nga fqinjët e Shqipërisë dhe se konferencat ndërkombëtare si ajo e Berlinit e Londrës dhe e Parisit vetëm sa bekuan këtë ndarje të padrejtë të popullit shqiptarë, i cili dikur ishte i shtrirë në tërë bregdetin Adriatik. Në anën tjetër, krenohej me luftërat epope të Skënderbeut kundër pushtuesit turk, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, kryengritjet e njëpasnjëshme të popullit shqiptarë për Pavarësi.

NGRITJA E FLAMURIT KOMBËTAR SHQIPTAR NË TETOVË

I brumosur me ideologji kombëtare, me 4 korrik të vitit 1968 në ditën e festës sllavomaqedone, Gafurri së bashku me shokun e tij Rafi Halilin, ngritën flamurin kombëtar shqiptar në Fabrikën e Tekstilit në Tetovë. Ishte akti i parë atdhedashës i këtyre dy shokëve, të cilën rrugë, s'do ta ndalin kurrë.

Me 22 dhjetor 1968, në Tetovë, organizohen demonstrata masive për përdorimin e flamurit. Krahas shumë të tjerëve në masën protestuese ishte edhe Gafurr Loku. Kur fotografisti Sreçko Janievski para masës dogji flamurin shqiptarë, ... "tre shokë nga Kosova, Gafurr Loku, njëfarë Idrizi dhe një tjetër që s'mund t'ia kujtoj emrin filluan ta sulmojnë me gurë e shufra hekuri policinë,... ndërsa ne u betuam që ta likuidojmë fotografistin Sreçko" (Demir Rashiti, Bisedë me Rafi Halilin,... Epoka e Re, 7 gusht 2001.)

E tërë kjo ishte vetëm fillimi i rrugës revolucionare të Gafurr Lokut. Pas përfundimit të shkollës së mesme, Gafurri regjistrohet në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë, ndërsa Rafi Halili në Fakultetin Juridik. Gjatë kësaj kohe formojnë grupin revolucionar "BASHKIMI", anëtar


i denjë i të cilit ishte edhe Gafurr Loku. Menjëherë pas themelimit të grupit, anëtarët e tij aktivitetin e shtrinë në ngritjen e celulave të "Bashkimit" si në "Shipkovicë, Xhepçishtë, Gajre, Zhelinë, Poroj, Reçicë, etj."(Po aty.)

Formimi i grupit "Bashkimi" në rrethanat e kohës kishte një rëndësi të madhe. Populli shqiptarë në Republikën Socialiste të Maqedonisë ishte i shtypur katërcipërisht, si në fushën politike, sociale, kulturore. "Bashkimi" para popullit shqiptarë doli me program politik dhe për realizimin e kësaj platforme shfaqeshin dy forma: ajo paqësore me demonstrata dhe nëse kjo nuk jep rezultate, realizimi i platformës politike parashihej me kryengritjen e armatosur. Për këtë qëllim "Gafurr Loku, Baki Imeri, Rushit Nesimi, Elmaz Ademi, Ajet Ademi dhe dy nxënës nga Zhelina, vodhën disa pushkë në gjimnazin e Tetovës..." (Po aty)

Programi politik i "Bashkimit" në masën shqiptare përhapej nëpërmjet pamfleteve, ndërsa me "1 maj 1972, me rastin e festës së punëtorëve, në disa qytete të Maqedonisë, Rafiu me shokët e lartëpërmendur i vendos flamujt kombëtarë. Në disa raste gjatë kryerjes së këtij aksioni pati edhe konflikte të armatosura me policinë".(Po aty.)

Kërkesat politike të "Bashkimit", shpërndarja e organizuar e pamfleteve, vendosja e flamujve kombëtarë nëpër qytetet shqiptare të Maqedonisë, krijuan një atmosferë shpërthyese. Në këto rrethana, UDB-a sllave kishte shtuar aktivitetin për arrestimin e anëtarëve të këtij

grupi dhe kjo ndodhi me 21 shtator të vitit 1972, ku në Prishtinë arrestohen Rafi Halili, Gafurr Loku, ndërsa në Tetovë, anëtarët e tjerë të grupit.



Gafurr Loku në mes më shokët e tij Rafi Halilin dhe Rushit Nesimin, fotografuar më 14.07.1978



Nga e majta: Rafi Halili, Mustafë Ismaili, Gafurr Loku



Gafurr Loku, studentë në Prishtinë

NË DUAR TË UDB-SË

Hetimet zhvilloheshin në Burgun e Qarkut të Shkupit. Torturat ishin aq të rënda saqë shëndeti i Gafurrit bie në masë të madhe, ndërsa Rafiu "pas hetimeve dy mujore" sëmuret nga veshkët dhe këmbët, kështu që e dërgojnë në spital, ku qëndron afër një muaj, nën përkujdesjen e shtuar policore". (Po aty.)

"Rafiun e pashë në një gjendje tejet të rëndë-dëshmon nën e Gafurrit, këmbët nuk mundette t'i lëvizte. Kur më mori në gryk më tha: Mos u mërzit, Gafurri është shumë mirë, mua më kanë dëmtuar pak, por edhe kjo kalon".

Se çfarë torturash bëheshin mbi të burgosurit shqiptarë më së miri do të përshkruajmë pjesë nga libri "Qëndresa" të dëshmorit Rexhep Mala, i cili ishte në të njejtin burg me Gafurr Lokun dhe në duart e të të njejtëve udbash, të cilët me mizoritë e tyre "bukën e bënin miell".

"... Filluan kështu torturat shtazarake të policisë fashiste jugosllave. Këta nuk ishin hetues, por bisha, që s'kishin kufij në shfrenimin e ndjenjave shtazarake, ishin si ujqër të uritur për mish njeriu; të etur për të pirë gjak... Më tepër se një muaj më merrnin në pyetje dy herë në ditë, para dite dhe në mbrëmje. Në këtë kohë me tortura intensive, nga dy hrë në dytë, çdo të

burgosuri politikë po t'iu kishte lënë në dispozicion të zgjidhte torturat apo plumbin, pa hamendje do të zgjidhnim këtë të dytin... Fytyra m'u pat enjtur dhe bërë mavi nga të rënat. Buzët i kisha të çara dhe nga çdo e rënë shpërthente gjaku... Të gjithë hetuesit dhe policët tjerë, 6-7 vetë, ishin në dhomën ku torturohej i burgosuri, dhe të gjithë me radhë ose bashkërisht merrnin pjesë në torturim... Nuk kishte gjë më prekëse e më trishtuese se sa kur dëgjoheshin gjëmët e shokëve... Më binin duarve aq sa duart nuk qëndronin dot më, dhe për të mos më lënë të pushoja ma mbanin dorën vetë dhe më goditnin parreshtur... Më kapnin me të dy duar për flokësh dhe ma përplasnin kokën për muri... Më kapnin për organe gjenitale dhe më bërtisnin në fytyrë: Kemi me të tredhë dhe më shtrëngonin gjersa alivanosesha..."(Rexhep Mala "Qëndresa")

Pas pesë muaj hetime, me 21 janar të vitit 1973 në Gjykatën e Qarkut të Shkupit, filloi gjykimi i grupit prej 5 anëtarëve. Aktakuza maqedone i ngarkonte me nenin 117 al.1 dhe 2 lidhur me nenin 100, që don të thotë: "Bashkim për veprimtari armiqësore kundër rendit dhe shtetit". Të akuzuarit ngarkoheshin se "kanë shkruar dhe shpërndarë pamflete me përmbajtje armiqësore për rrëzimin e pushtetit të klasës punëtore, shkatrrimin e bashkimit dhe vëllazërimit të kombeve e kombësive të Jugosllavisë si dhe nga gjimnazi "Kiril Pejqinoviq" i Tetovës, arritën t'i marrin armët nga kabineti paraushtarak me qëllim që të rezistojnë...".

Pas përfundimit të shoshitjes gjyqësore, ku të akuzuarit, mbrojtën me këmbëngulje bindjet e tyre politike, gjykatësi shpalli dënimet:

Rafi Halili	7 vite burg
Gafurr Loku	5 vite burg
Rushit Nesimi	5 vite burg
Elmaz Ademi	4 vite burg
Ajet Ademi	2 vite e 6 muaj burg.

Në aktgjykimin nr.168/73 ku përpos që vërtetohen dënimet e shqiptuara thuhet se:

"Të akuzuarit janë fajtor për veprën penale-bashkim kundër popullit dhe shtetit - nga neni 117 kështuqë Rafi Halili dënohet nga alineja 1 i këtij ligji, ndërsa të akuzuarit tjerë nga alineja 2 lidhur me nenin 100 të Ligjit Penal... Rafi Halili së bashku me personin Baki Imeri student nga Shipkovica e Tetovës, i cili gjendet në arrati, nga vjeshta e vitit 1971 e deri në ditën kur u zbuluan në shtatorin e vitit 1972 në Prishtinë dhe në rrethinën e Tetovës, kanë themeluar platformën politike kundër popullit dhe shtetit, ku edhe formuan grupin i cili kishte për qëllim që me forcë dhe në mënyrë kundër kushtetuese të rrëzojnë pushtetin e klasës punëtore dhe të shkatërrojnë bashkim-vëllazërimin e kombeve të Jugosllavisë dhe në këtë grup angazhuan edhe Gafurr Lokun, Rushit Nesimin, Elmaz Ademin, Ajet Ademin dhe persona të tjerë, duke shkruar dhe shpërndarë pamflete me përmbajtje armiqësore..."

Burgun e vuajtën në Idrizovë, një burg tmerri e mizerie, siç thotë Rafiu, dhe krahas këtyre, kishte edhe të burgosur të tjerë politik, si: Rexhep Mala, Xhafer Shatri, Sejdi Kryeziu, Hasan Dërmaku, etj. Krahas të burgosurve politik, kishte edhe shqiptarë për delikte të tjera si p.sh. Naip Beçiri nga Tanusheci i cili kishte vrarë një kasap sllav në afërsi familjare me një pushtetar maqedonas. Naipi kishte vrarë kasapin sepse ai i kishte sharë nënën shqiptare dhe Naipi pa u menduar fare ia shuan jetën me 9 plumba. Të burgosurit politik në Idrizovë e afrojnë Naipin në gjirin e tyre shoqëror dhe ia mësojnë alfabetin e gjuhës shqipe. I afrojnë libra për lexim dhe më vonë Naipi, fillon të shkruaj këngë, poezi, tregime...

Në pyetjen e publicistit Fadil Curri: A mund të na thoni ndonjë mbresë nga burgjet?

Naip Beçiri përgjigjet: "Po. Në burgun e Idrizovës isha bashkë me disa intelektual, si Mehmet Gega, Shpëtim Pollozhani, Beqir Berisha. Në saje të tyre mësova jo vetëm të shkruaj mirë, por nisa edhe të krijoj punime letrare..." (Fadil Curri "A(h)fati(h)ynë në peshojë, fq.134.)

Jeta në burgun e Idrizovës ka qenë shumë e rëndë. Të burgosurit politik kanë qëndruar së bashku me kriminelët e burgosur sllavomaqedon të cilët të yshtur nga personeli i burgut, vazhdimisht i kanë provokuar të burgosurit shqiptarë. Pas çdo zënke, të burgosurit shqiptarë i mbyllnin nëpër vetmia ku edhe pasonin

torturat për "thyerjen e rendit shtëpiak" UDB-a sllave inskenonte edhe konflikte kolektive ndërmjet shqiptarëve dhe sllavëve, ku pas çdo konflikti kishte të vdekur apo të lënduar rëndë dhe për gjithë këtë fajtorë mbeteshin përsëri të burgosurit shqiptarë.

"Shumë krime janë bërë në burgjet e Jugosllavisë mbi shqiptarët. Shumë vetë janë vrarë e therë me bajoneta duke ikur, shumë të tjerë janë shkallmuar me dru... Si pasoj e kësaj gjendje nëpër burgje kanë plasur shumë kryengritje të të burgosurve shqiptarë të cilat janë shuar me terror e reprezalje të padëgjuar. Kryengritës të tillë ose janë pushkatuar, ose janë mbytur në dru... Shembuj të tillë ka mjaftë si në kapedomin e Nishit, Zabella e Pozharevcit, Spuzh të Titogradit; në Stara Gradishkë, në Lepogllavë etj. Në kampin Idrizovë u mbytën dy të burgosur shqiptarë me pranga në duar... Në Spuzh të Titogradit, gardianët hapën zjarr në të burgosurit politik shqiptarë, duke plagosur disa sish... Në Nish policia hapi zjarr kundër të burgosurve shqiptarë duke vrarë e plagosur disa prej tyre. Në Zabella të Pozharevcit, drejtoria e burgut e organizoi masakrën e njohur ndërmjet të burgosurve shqiptarë e serbë. Epilogu: katër të burgosur serbë të vrarë, shtatë të tjerë të plagosur rëndë dhe dhjetra sish të plagosur lehtë. Pas masakrës, katër shqiptarë, të cilët në vetëmbrojtje të domosdoshme u detyruan të vrasin të burgosurit serbë të nxitur nga drejtoria u dënuan me pushkatim. ("Rexhep Malaj" Qëndresa" fq.63,64.)

Кж.бр.168/73.

Во Име на народот!

ВРХОВНИОТ СУД НА [illegible] - Скопје, во совет од петмина, составен од судиите: Тодор Кесапетов, како претседател на советот, [illegible] Гулејков, Димитар Солев, Крајко Пиков и [illegible] Јовевски, како членови на советот, со записничарот Катица Гошева - стручен соработник, во кривичниот предмет против обвинетите Рафи Халили, Гафур Јоку, Рушит Песими, Елмаз Адеми и Ајет Адеми, сите од Тетово, за кривично дело од чл.117 ст.1 во врска со чл. 100 од КЗ, решавајќи по изјавените жалби на обвинетите поднесени преку нивните бранители Илија Марков, Сејди Рауф Бајрами, Богдан Јокимовски и Абдула Прекова, адвокати од Скопје, против пресудата на Окружниот суд во Скопје, К.бр.474/72 од 26.I.1973 година, на својата јавна седница одржана на ден 27.IX.1973 година, согласно чл.341 од ЗКП, во присуство на странките и по изјавување на истите, а после изборот на вер.Републички јавен обвинител - Александар Стојановски, ја донесе следната

П Р Е С У Д А


Жалбите на обвинетите Рафи Халили, Гафур Јоку, Рушит Песими, Елмаз Адеми и Ајет Адеми, сите од Тетово, поднесени од нивните бранители и тоа: Илија Марков, Сејди Рауф Бајрами, Богдан Јокимовски и Абдула Прекова, адвокати од Скопје, [illegible] се одбиваат.

Пресудата на Окружен суд во Скопје, К.бр.474/72 од 26.I.1973 година, [illegible].

О б р а з л о ж е н и е

Окружниот суд во Скопје, со пресуда К.бр.474/72 од 26.I.1973 година, обвинетите Рафи Халили, Гафур Јоку, Рушит Песими, Елмаз Адеми и Ајет Адеми, со генерални како во цитираната пресуда ги огласил виновни за кривично дело здружување против народот и државата од чл.117 и тоа обвинетиот Рафи Халили по став 1 а останатите обвинети по став 2 од член 117 во врска со чл.100 од КЗ, затоа што обвинетиот Рафи Халили заедно со лицето Рафи Хмери студент од с.Бишковица - Тетовско, кој е во бегство во времето од есента на 1971 година па се до откривањето во месец септември 1972 година во Приштина и во подрачјето на општина Тетово изградиле политичка платформа за делување против народот и државата, заради што и создале група која имала за цел да со сила и противуставен пат ја соборат власта на работничкиот народ и да се разбие братството и единството на народите од Југославија при што им приоѓале на одделни лица од албанската народност и ги врабувале да постанат членови на групата па по таков начин во истата ги врабувале обвинетите Гафур Јоку, Рушит Песими, Елмаз Адеми, Ајет Адеми и други лица, што овие и го чинеле, пикувале летоци со непријателска и

Faksimil nga aktgjykimi nr.168/73



Управата на Казнено-поправниот Дом - Идризово согласно Чл. 169 од ЗИКС ја издава следната:

П О Т В Р Д А

Дека лицето ЈОКУ ЏАФИР ГАФУР роден 11.08.1948 год. во с.Котлина општина Качаник а живее во Тетово општина Тетово, осуден со пресуда К.бр. 474/72 од 26.1.73 год. на Окружен суд во Скопје на казна строг затвор во траење од 5 години. Именованиот е ослободен од овој КП Дом на ден 21.09. 19 77 година по истек. Казната ја издржуваше од 21.09.1972 год. до 21.09.1977 година.


При ослободувањето на именованиот исплатена му е парична заштеда во износ од _____ дин. а од страна на Управата на Домот обезбедена му е помош и тиа _____

Референт,

Faksimil nga kohëzgjatja e dënimit, 21.9.1972 - 21.9.1977

Në burgjet sllave, të burgosurit politik shqiptarë, vazhdimisht ishin nën këto reprezalje. Nëpër këto situata kaloi edhe i pathyeshmi i Tetovës, Gafurr Loku, i cili dënimin e shqiptuar nga Gjykata e Qarkut në Shkup e mbajti të tërin pa gëzuar asnjë ditë amnestie.

Megjithatë, nga burgu, Gafurr Loku kishte nxjerrur një përvojë të madhe, njëkohësisht një urrejtje edhe më të madhe për pushtuesin, i cili me tërë arsenalin e tij shtypës tentonte të shuante dritën e lirisë, por koha është dëshmitare se një popull kurrë s'mund të mbahet në robëri nëse ai e dëshiron lirinë. Dëshmi për këtë janë ngjarjet e vitit 1981 në Kosovë, demonstratat e njëpasnjëshme të popullit shqiptarë deri në organizimin e kryengritjes së armatosur të dy UÇK-ëve në Kosovë dhe Maqedoni.



Disa ditë pas daljes nga burgu i parë, djathtas Gafurr Loku

LIRIMI NGA BURGU I PARË

Pasi lirohet nga burgu i Idrizovës, Gafurri niset në drejtim të Kosovës, gjegjësisht në fshatin Seqishtë të Hanit të Elezit pasiqë familja e tij para pak kohe ishte shpërngulur nga Tetova. Torturat e rënda në burgje kishin dëmtuar shëndetin e Gafurrit, kështu që për tre muaj me radhë qëndron i shtrirë në spitalin e Prishtinës. Krahas kësaj, sërish vazhdon studimet e mbetura në gjysmë nga viti 1972 dhe njëkohësisht zgjeron rrethin e tij shoqëror, gjithnjë duke propaganduar çështjen e atdheut. Martohet me Hasibe Rakën nga Kaçaniku dhe një vit pas martesës, në vitin 1979 u lind fëmiu i

tij i parë Dritoni, të cilin serbët do ta vrasin pas njëzet vjetëve.

"Dy muaj pas lindjes së Dritonit-rrëfen bashkëshortja e Gafurrit-Hasibja, nga Fusha e Seqishtës u shpërngulëm në Tetovë, ku atje arrita t'i njoh përsëafërmi shokët e Gafurrit si Rafiun, Elmazin, Rushitin, Ajetin. Ata vinin shpesh te ne dhe me Gafurrin bisedonin për çështjen e atdheut".

Në vitin 1980, ftohet për të kryer shërbimin ushtarak në Sarajevë, por në armatën jugosllave qëndroi vetëm 3 muaj ditë pasiqë fiton nga një ligj i nxjerrur për ushtarët që ishin të shtyrë në moshë.


Gafurr Lokun e kishim nip shtëpie. Ishte i dashur për të gjithë. Kur vinte te ne, gëzoheshin edhe gurët e oxhakut-siç thot populli. Ishte komunikativ dhe i afërt. Fjalori i tij popullor dhe gjuhën letrare të cilën e fliste rrjedhshëm, të bënin për vete. Kur u regjistrova në SHLP në Prishtinë u gëzua shumë.

- Ke lexuar romanin "Afërdita"?

- Jo. I them

- Ta jap unë, më tha Gafurri, që të mësosh se sa duhet t'i duash nxënësit. Dhe vazhdoi: Arsimi është i shejtë. Çdo herë dhe në çdo kohë shkolla dhe abetarja janë djegë e përvëlu nga pushtuesit e huaj... Dikur moti kur shqiptarët nuk kishin shkolla, dritën e parë e sollën mërgimtarët që punonin në mërgim. Atje, shqiptarët kishin organizuar shoqëri të ndryshme me motive politike. Shqiptarët që punonin në Rumani bënë një punë të madhe

kombëtare, andej sollën edhe abetaret e para, sepse shqiptarët natyrisht se shqip flisnin, por gjuhën e tyre s'kishin me se ta shkruanin. Greku gjuhën tonë e quante "bastarde", ndërsa turku "gjuhë djall". Herën tjetër më solli një roman shumë të mirë "Për Mëmëdhenë" të Thoma Kacorit.



Gafurr Loku në spitalin e Prishtinës, 6 maj 1978

PËRSËRI NË TETOVË

Gafurri e dinte se UDB-a maqedone e ndjek-te këmba-këmbës, andaj kishte kujdesë në lëvizjet e tij. E kishte perfeksionuar "gjuhën politike" të Ezopit dhe më kujdesë zhvillonte idenë e temës që natyrisht ishte me përmbajtje të thellë kombëtare. Në çdo bisedë të tij zente vend bashkimi brenda shqiptarë dhe arsimimi kombëtarë. Shpesh përmendëte aktivitetin shkencor të hoxhë Hasan Masuricës.

Sa ishte gjallë Xhemal Fera i Bllacës, anëtar i Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH) ku në burgun e Idrizovës kishte mbajtur 12 vite burg, kontaktonte shpesh me atë. Në një rast kur po ktheheshim nga fshati Bllacë, më thot:

"Xhemajli ka qenë njeri i besës, luftëtar i Shqipërisë etnike. Kur maqedonët e arrestuan, shëndeti i tij u dëmtua shumë. Ja, te ky gurë ka pas fshehur mitralezin e tij. Kur hetuesit ia zbuluan armën dhe kur e kishin pyetur "se çka t'u është dashur ty kjo armë?", Xhemajli iu kishte përgjigjur: Armën e kam ruajtur për ju që keni pushtuar viset e Shqipërisë etnike".

Ngjarjet e vitit 1981 Gafurrin e gjejnë në Tetovë. Jo vetëm që i përkrahu, por ishte propagandues i shkëlqyeshëm i Republikës së

Kosovës. "Kur Maqedonia e Mali i Zi kanë të drejtë me një grusht popull, pse Kosova s'ka të drejtë të ketë statusin e Republikës?!" dhe fliste e fliste për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, për Kongresin e Berlinit, Konferencën e ambasadorëve në Londër, luftërat e Azem Bejtë Galicës, Mbledhjen e Bujanit, kuvendin antishqiptar të Prizrenit të vitit 1945, aksionin e armëve të Aleksandër Rankoviqit, shpërnguljen e shqiptarëve për Anadoll...



Nga e djathta: Gafurr Loku me autorin e librit, 1980

Pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981 në Prishtinë, shkova mysafirë te Gafurri në Tetovë. Ka jetuar afër stadionit të futbollit të Tetovës. Ishte mikpritës i madh, nuk kursente asgjë për mysafirin. Mbi të gjitha përshtypje më bëri biblioteka e tij. Kishte një bibliotekë shumë të pasur. E ruante dhe e zgjeronte me knaqësi. Orëve të mbrëmjes më ftoi t'i dëgjonim lajmet. Përcjellnim Radio Tiranën. U strukëm në qoshe të dhomës dhe dëgjonim zërin kumbues të gazetarit për ngjarjet në Kosovë. Zërin e Radios e uli. Kur kërkova t'ia lëshoj edhe më tepër zërin, tha: UDB-a i ka veshët e hollë, madje ka mjete që të dëgjon edhe nga rruga. Meqë unë, ende

nuk isha përballur me "veshët" dhe mjetet e UDB-së, pak kuptoja në atë kohë se ç'donte të thoshte Gafurri. Por, kur edhe unë u përballa me hetuesin dhe burgun sllav, atëherë edhe më shumë m'u kjartësua situata nëpër të cilën kaluan gjeneratat si e Gafurrit dhe në tërsi populli shqiptarë.

Në dokumentacionin familjar të Gafurr Lokut, gjejmë edhe një Kontratë mbi dhënien e një dhome për banim paqira e nënshkruar nga Gafurr Loku dhe baballaku i tij Hamdi Raka në Kaçanik.

...Kontraktuesi Hamdi B.Raka, i jep kontraktuesit Gafurr Lokut, një dhomë nga shtëpia e tij e ndërtuar në rrugën "Migjeni" nr.40, e cila ka dimenzionin 4x4 m." Gjithashtu në kontratë thuhet se" për dhomën e dhënë për banim kontraktuesit Gafur Loku, kontraktuesi Hamdi Raka nuk ka kërkuar kurrfarë kundërvlere, pasi që kontraktuesi Hamdi është i vjehrri i kontraktuesit Gafurr". Kjo kontratë është e lidhur me datën 15.07.1981 pranë Gjykatës komunale në Ferizaj-Dega në Kaçanik e nënshkruar nga referenti për vërtetime Gani Sopa.

Në një shkresë tjetër hasim një kërkesë të Gafurr Lokut të datës 3.1.1979 drejtuar Organizatës për prodhimin ndërtimor "Sharr" në Han të Elezit, ku Gafurri kërkon bursë ose kredi për vazhdimin e studimeve të mëtejme... Jam student i vitit të III-të pranë Fakultetit Ekonomik në Prishtinë dhe meqë nuk jam shfrytëzues i asnjë burimi financiar studentesk, kërkoj që t'më ndani një bursë apo kredi për studime të mëtejme...".

* * *

Shpërthimi i demonstratave të 11 marsit 1981 dhe demonstratat që u zhvilluan më pas, në Kosovë dhe rajon, krijuan një situatë të re. Populli shqiptarë për të satën herë dëshmonte se nuk dëshironte të jetonte nën sqetullën sllave, andaj rinia jonë studenteske së cilës i printe ilegaliteti, doli me kërkesën politike Kosova-Republikë, nëpërmjet së cilës, Kosova duhej të bëhej republika e shtatë në Federatën Jugosllave. Republika e Kosovës me të drejta të barabarta në ish-Jugosllavinë e Titos, do të ishte një avansim politik, por shovenistët jugosllav jo vetëm që nuk e përkrahën një kërkesë të tillë, por në drejtim të Kosovës nisën tankset serbe dhe xhelatët shkie. Paria shqiptare e Kosovës atëbotë në vend që të përkrahte këtë kërkesë, në një takim që mbajtën në Gjakovë, rininë studenteske të Kosovës e quajtën "plehu" i Kosovës, por brenda natës, populli nëpërmjet trakteve u përgjigj: Jo rinia, por tradhëtarët janë plehu i Kosovës. Me këtë dua të them se popullin shqiptarë, pushtuesi po e ndante në dy pjesë. Në njërën anë mbetën shërbëtorët e pushtuesit me arsenalin e dhunës, ndërsa në anën tjetër liridashësit. E vetmja përkrahje për liridashësit kosovar, atëbotë vinte vetëm nga Shqipëria e cila nëpërmjet "Zërit të Popullit" dhe nëpërmjet valëve të Radio Tiranës, mbështette demonstratat popullore dhe çjerrte maskën pushtuesit serb.

Okupatori, në drejtim të Kosovës, nisi ushtrinë dhe policinë jugosllave dhe me çdo kusht dëshironte ta shuaj me gjakë rezistencën shqiptare, ndërsa në këndin politik, aktivizoi llogjet e lakenjve titist për të bërë diferencimin politik brenda popullit shqiptarë.

Në një dokument të asaj kohe, gjetur në shkarravinat e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë me titull: Sekret ushtarak (vojna tajna), një diferencues shqipfolës ndër të tjera shkruan:

"Jugosllavia kësaj radhe u ballafaqua me kundërrevolucionin nga nacionalizmi dhe irredentizmi shqiptarë. Një parullë e tillë është dëgjuar edhe në vitin 1968 dhe qëllimi i kësaj parulle është tubimi i të gjithë shqiptarëve në një Republikë Shqiptare, gjë që nuk duhet pranuar në asnjë mënyrë".

Në rrjedh të kësaj, KQ i LKJ-së nxori edhe Platformën politike kundër irredentizmit shqiptar dhe apostrafonte me të madhe luftën kundër Republikës së Kosovës. E përditshmja kosovare "Rilindja" ra në shërbim të plot të kësaj Platforme dhe cenzuronte çdo shkrim që sado pak kishte elemente kombëtare. Në censurë të plotë u vendos e tërë krijimtaria letrare, madje edhe karikaturat e artëdashësve. Kundër RTSH-së ushtria jugosllave vendosi repetitorë të fuqishëm, por si për inat të tyre valët e TV Shqiptar arrinin të depërtonin në shtëpitë shqiptare dhe lufta kundër kësaj Platforme politike antishqiptare vazhdonte si nga Shqipëria e po ashtu edhe nga forcat e ilegalitetit të cilat

edhe pse të dëmtuara, ruanin vazhdimësinë e veprimtarisë. Një luftë të fuqishme politike kundër kësaj platforme politike antishqiptare zhvillonte edhe dëshmori Gafurr Loku.

Përkundër tendencave për mbytjen e idesë për Republikën e Kosovës që zhvillonte pushtuesi, demonstratat popullore për Republikën e Kosovës shpërthyen edhe në perëndim, ku mërgimtarët tanë kishin shkuar për të siguruar bukën e gojës. Atje, nën organizimin e Jusufit, Bardhoshit dhe Kadriut, mërgata shqiptare po konsolidohej dhe me demonstratat e tyre, shesheve të Evropës, sensibilizonin botën perëndimore për shtypjen dhe dhunën që ushtrohej në Kosovës. Me 18 prill 1981, në Cyrih të Zvicrrës, para masës së tubuar dëshmori Kadri Zeka ndër të tjera thot:

"Sot populli ynë, i bashkuar si çdo herë në momentet e rëndësishme historike, njëzëri kërkon të drejtat e tij të ligjëshme:

1. Republikën e Kosovës me të gjitha tokat shqiptare në Jugosllavi.
2. Të drejtat e popullit tonë për vetëvendosje deri në shkëputje.
3. Lirimin pa kusht të të gjithë të burgosurve politikë shqiptarë dhe kthimin në Kosovë të të burgosurve të tjerë.
4. Të mos plaçkiten pasuritë e Kosovës nga republikat jugosllave, por ato t'i shfrytëzojë Kosova për zhvillimin dhe përparimin e vet.
5. Të drejtën e kremtimit të festave kombëtare dhe të përdorimit të flamurit nga të

gjithë shqiptarët në Jugosllavi..." (Kadri Zeka "Refleksione" fq.67.)

Për kundër dhunës barbare sllave, populli shqiptarë nuk ndaloi në rrugën e lirisë. Me 13 maj 1981 Tahir e Nebih Meha pushtuesit i shkrepën pushkën. Lirisë po i hedheshin themelet. Me sakrifica të shumta, flamuri i çlirimit bartej nga qyteti në qytet, nga fshati në fshat, nga rruga në rrugicë. Burgjet sllave u mbushën me rininë shqiptare. Urrejtja ndaj pushtuesit shtohej çdo ditë. Një urrejtje të tillë kishte krijuar edhe Gafurri që me kohë, por terrori udbesk sllav sillej si fantazmë mbi kokën e çdo atdhedashësi. Kthetrat e tij po i rikthente sërish nga Gafurr Loku.



Gafurr Loku, 1981

ARRESTIMI I DYTË

Edhe pas daljes nga burgu, Rafi Halili nuk pushoi veprimtarinë ilegale. Në Tetovë formon organizatën ilegale politike "KUSHTRIMI I LIRISË" nëpërmjet së cilës kërkonte të drejtat e popullit shqiptar në Maqedoni. Atë botë shkruan Memorandumin 7 faqësh me titull: "500 mijë Shqiptarë të Republikës së Maqedonisë Kërkojnë dhe Protestojnë", të cilin e shpërndanë, nëpërmjet postave, krerëve të pushtetarëve titist. Në Memorandum kërkoheshin të drejtat e popullit shqiptar dhe e drejta e vetëvendosjes.

"Një natë, rrëfen Hasibe Loku, Gafurri solli disa materiale ilegale në shtëpi. I lexonte me ëndje. "I kam marrë nga Rafiu, më tha. Kur Rafiu ishte në arrati, me Gafurrin kontaktonte nëna dhe motra e Rafiut të cilat edhe këto do të dënohen me burgim shumë vjeçarë". Nga kjo kuptojmë se Gafurr Loku ishte edhe anëtarë i "Kushtrimit të Lirisë", por kjo i mbetet e pazbuluar gjatë tërë kohës së hetimeve edhe pse ndaj Gafurrit u bënë tortura të rënda.

Me 9 mars të vitit 1982, në vixhilje të një vjetorit të demonstratave të 81-shit, shpërndahen pamflete në shumë rrugë dhe qytete të

Maqedonisë. Ky aksion ishte shkas që UDB-a sllavomaqedone të ndërmerr bastisje dhe arrestime në shkallë të gjërë. Bastiset shtëpia e Gafurrit në Tetovë, por meqë ai nuk gjendet në shtëpi, arrestojnë vëllezërit e tij: Shefketin, Muhametin (ndërkohë lirohen) dhe Kadriun (lirohet pas tre muaj dite).

"Ishte ora 5 e mëngjesit. Policia maqedonase kishte rrethuar shtëpinë. Gafurri gjendej në Kaçanik. Me të shpejtë u futa në dhomë dhe materialet që i kishte Gafurri dhe që i dija se ku gjendeshin, i dogja me shpejtësi. Policia hypën në katin e dytë të shtëpisë dhe kërkuan që të futen në dhomën time. Bastisen gjithandej. Nga biblioteka e Gafurrit morën një kufer me libra dhe një makinë shkrimi. Më vonë kuptuam se kishin gjetur edhe një audiokasetë me përmbajtje politike nga Shqipëria..." - rrëfen Hasibe Loku.

Ishte 11 marsi i vitit 1982. Gafurri ndodhej në Kaçanik. Të nesërmen në mbrëmje arriti në Paldenicë. Posa u falëm me te, më tha:

"Dajë, shtëpinë time e ka bastisur policia maqedone. Kanë arrestuar anëtarët e familjes. Ka gjasë t'i kenë gjetur disa shirita të magnetofonit rreth ngjarjeve në Kosovë. Flitet se ka arrestime të shumta" dhe shpërtheu me tërë fuqinë e tij:

"Derisa të jemi të coptuar, kurrë policët sllav s'kanë për t'u larguar nga shtëpitë tona. Derisa të jemi nën këmbën e maqedonit, malazezit dhe serbit, plagët tona kurrë s'do të shërohen, andaj

vetëm bashkimi ynë kombëtar e territorial do të zgjidh një herë e përgjithmonë fatin tonë. Për këtë qëllim dhe për këtë ideal, jetën e dhanë dhe do ta japin kush e din edhe sa e sa atdhetarë. Pa bashkim s'ka fuqi, pa bashkim s'ka liri..."

Ndejtëm deri vonë. Para se të binim për të fjetur, më kërkoi shampon dhe pastroi kokën. "Po e pastr'oj edhe një herë se Zoti e din se kur do ta pastroj më". I prekur nga këto fjalë i thashë:

- Gafurr, mos u dorëzo, kalo në Shqipëri.

- Jo - u përgjigj. Shqipëria ka siguruar lirinë e saj, ne duhet ngulur këmbët këtu. Ne duhet të fitojmë lirinë tonë, pa marrë parasysh sakrificat...

U arrestua, të nesërmen, me 13 mars 1982 në Kaçanik, pasiqë UDB-a sllavomaqedone ia kishte bastisur dhomën në rrugën "Migjeni" në Kaçanik. Arrestohet nga udbashët e Kaçanikut dhe e dorëzojnë te UDB-a maqedone që po e priste në lokalet e UDB-së, përkundër kërkesës së Gafurrit që hetimet të zhvillohen në Kosovë. Ra përsëri në duart e udbashit Bedri Sinani i cili që me kohë kishte dhënë betimin sllav se "dersa të ket shpirt Bedri Sinani, Gafurr Loku dhe Rafi Halili s'kanë për të parë dritë kurrë" dhe vërtetë ashtu ndodhi.

Edhe në vendimin për paraburgim të datës 14.3.1982 shihet kjartë emri dhe mbiemri i Bedri Sinanit dhe nënshkrimi i tij si shef i UDB-së maqedone në Tetovë. Në anën e majtë të këtij vendimi është nënshkrimi i Gafurrit dhe ora e pranimit të vendimit 21,25 minuta.

Hetimet filluan në burgun e Shuto Orizarës me akuzë se:

"Në orët e mbrëmjes të 9 marsit 1982 në rrugën e "Lubotenit", "Pollogut", "Prespës", "Gj.Petrovit", "Shtipit", "Vardarit", "Bitolit" dhe në fshatin Poroj të Tetovës ka shpërndarë pamflete me përmbajtje armiqësore..."

"Hetimet zgjatën rreth katër muaj. Për shtat ditë me radhë më mbajtën pa gjum për t'më dobësuar koncentrimin. Udbashët ndërroheshin çdo dy orë. Në një rast kur më mbanin me gishtrinjë mbështetur në murë, krahët dhe gishtat e dorës mu dukën si hunjë. Rashë në tokë i alivanosur. Përsëri tortura... Kërkonin rrënjët e organizatës, "Kushtrimi i lirisë" - rrëfente dëshmori Gafurr Loku.

Duke mos patur mundësi për ta zbërthyer këtë titan, Gjykata e Qarkut në Shkup e dënoi me 3 vite e 6 muaj burg për "propagandë armiqësore" me një akuzë tjetër se paska përcjellur emisionet e Radio Tiranës, ka inçizuar emisionet politike rreth ngjarjeve në Kosovë dhe të ngjajshme. Dënimin e vuajti të tërin sërish pa asnjë ditë amnestie në burgun e Idrizovës dhe kurë llogarisim edhe burgun e parë, Gafurr Loku mbajti gjithsejt 8 vite e 6 muaj burg.

"Kur shkova ta vizitoj Gafurrin në burg, rrëfen e ëma e tij Rabishja, në xhep i kisha tri kumbulla. Nxora nga xhepi njërën dhe ia dhashë Gafurrit. Gardianët si të lemeritur ia nxorën me dhunë nga goja kumbullën dhe pasi e kthejnë në dhomën e burgut, kumbullën e nënës e

paguan me torturë. Kisha dëshirë, vazhdon e ëma e dëshmorit, që me dorën time t'i japë diçka Gafurrit dhe ta shijonte stinën që po e kalonim ne, por..."

"Kur shkonim në vizita, gardianët na ndalonin të flisnim në gjuhën shqipe, por edhe Gafurri nuk fliste në maqedonishte sepse ne nuk e kuptonim atë gjuhë të huaj, rrëfen Hasibe Loku. Shumë herë vetëm jemi shikuar ndërmjet veti pa folur asnjë fjalë dhe vizita përfundonte... Më vonë caktuan një përkthyes i cili natyrisht ishte agjent i UDB-së dhe merreshim vesh".

Ndaj Rafi Halilit ka pasur një dashuri të veçant. Rafiu, thoshte Gafurri, është i tëri revolucionar. Është ndër të burgosurit që është keqtrajtuar më së shumti. Kjo nuk don të thot se të tjerët kanë kaluar lehtë. Kur UDB-a maqedone e arrestoi me 9 qershor 1982 ai ua shkrepi pushkën. I plagosur, me gjakun e tij, nëpër çarçafët e burgut shkruante më të shtrenjtën fjalë LIRI. Më kujtohet një rast tjetër, kur tregonte për Shpëtim Pollozhanin, të cilin gjithashtu e ka dashur shumë, se si Shpëtimi kishte triumfuar ndaj të burgosurve psiqik, të cilin, pra Shpëtimin, drejtoria e burgut e kishte futur në një dhomë me ata.

К.74/82

ОКРУЖЕН СУД ... ПРИМЕНО на 11.VI 1982 ... 24

ОКРУЖНО ЈАВНО ОБВИНИТЕЛСТВО
КТ бр.132/82
Скопје, 11.6.1982 година

БМ/ЗЛ

8

ДО ОКРУЖНИОТ СУД

С К О П Ј Е

Врз основа на чл.45 ст.2 т.3 и чл.174 ст.2 од ЗКП, поднесувам

ОБВИНИТЕЛЕН АКТ

ПРОТИВ:

ГАЈУР ЈОКУ, од татко Џафер и мајка Рабије Чукри, роден 11.8.1949 година во с.Котлина-САП-Косово, живее во Качаник, на ул."Ми Џени" бр.4о, Албанец,државјанин на СФРЈ, писмен со завршено гимназија, женет,татко на 2 малолетни деца, војска служел во 1980 година во Сарајво, се води во воена евиденција при СО-Качаник, необвинуван, безимотен, осудуван во текот на 1972 година за кривично дело Здружување заради непријателска дејност од чл 117 од поранешниот КЗ, казната ја издржал, не се води постапка за друго кривично дело, во притвор од 14.3.1982 година од кога и се брани,

ЗАТОА ШТО:

На точно неутврдени дати во текот на м.април к мај1981 година во неговиот стан во Тетово а со цел понатаму да го растура на сопствениот магнетофон на три касети снимил две говорни емисии на радио Тирана на албански јазик во врска со контрареволуционерните настани во САПКосово од пролетта на 1981 година преку кои се дадени коментарите на весникот "Зери ми попучит" во врсака со тие настани, а преку кои грубо, злонамерно и невистинито се прикажани истите,подржано барањето Косово Република како и злонамерно и невистинито се прикажани општествено-политичките прилики во земјата, како и една касета со песни на албански јазик преку кои се велича личноста на Енвер Хоџа и состојбите во Албанија.

Со горните дејанија обвинетиот Гафур Јоку сторил кривично дело Непријателска пропаганда по чл.133 ст.1 од КЗ на СФРЈ.

.....

Faksimil i vendimit për zgjerimin e hetimeve nr.36/82

КИО.бр.36/82

Р.

ИСТРАЖНИОТ СУДИЈА ПРИ ОКРУЖНИОТ СУД ВО СКОПЈЕ, Свето Тасевски, постапувајќи по барањето за спроведување на истрага со предлог за одредување на мерката - притвор Кт.бр.52/82 од 15.III. 1982 година, против РАФУР ЛОКУ, од Качаник, поради постоење на основано сомнение да сторил кривично дело - непријателска пропаганда по чл.133 ст.1 од КЗ на СФРЈ, па согласно чл.159 и чл.191 ст.2 т.1, 2, 3 и 4 од ЗКП, на ден 15.III.1982 година, го донесе следното

Р Е Ш Е Н И Е

I.

СЕ СПРОВЕДУВА ИСТРАГА против:

РАФУР ЛОКУ, од татко Шафер и мајка Рабије, роден на 11.8. 1949 година, во с.Котлина - Качаник, живее во Качаник на ул."Мифени", бр.4о, албанец, државјанин на СФРЈ, студент, женет, татко на две деца, осудуван со пресуда на Окружниот суд во Скопје, за кривично дело - непријателска пропаганда од чл.119 ст.1, на казна - затвор во траење од 5 години, истата ја издржал, во притвор од 14.III.1982 година.

Поради постоење на основано сомнение да сторил кривично дело - НЕПРИЈАТЕЛСКА ПРОПАГАНДА од чл.133 ст.1 од КЗ на СФРЈ.

Со тоа што, со растурање на летоци повикувал и поттикнувал на соборување на власта на работничката класа и работните луѓе, на противуставна промена на социјалистичкото самоуправно општествено уредување, на разбивање братството и единството и равноправноста на народите и народностите и злонамерно и невистинито ги прикажувал општествено-политичките прилики во земјата на начин, што во вечерните часови на 9.III.1982 година, во Тетово низ повеќе улици "Суботенска", "Полог", "Преспанска", "Г.Петров", "Штипска", "Вардарска", "Битолска" и други и во селото Порој - тетовско, растурал поголем број на летоци со непријателска содржина на албански јазик, пишувани на машини за пишување и на неправилен македонски јазик умножени на шепилограф или пак на друга слична примачна техника во кои со пароли: "дигнете се на нозе, браќа и сестри албанци .... нацифашистите, македоносрбите не ни ја поклонуваат слободата и соединувањето...., сите да се заложиме нештедејќи го животот, со кои се повикува на противуставно соборување на власта на работничката класа и на непријателска активност против СФРЈ, понатаму со текстот во нив "да живее Енвер Оџа, НР Албанија....да живее соединувањето.... република од Струга до Скопје, Косово, Улцин и НР Албанија - едно", исто така се повикува на противуставна промена на социјалистичкото уредување во СФРЈ.

PËRSËRI NË KOSOVË

Pas burgosjes së dytë, familja e Gafurrit, nga Tetova sërish kthehen në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit. Babai i tij, Xhaferi një kohë të gjatë lëngoi në shtrat. Nuk kishte fuqi të shkonte të vizitonte djalin e tij. Kur shkova të vizitoja me një shok timin, ndjeva keqardhje që s'po mundet ta pres Gafurrin derisa të lirohet nga burgu. Shoku im më tha: Jo, unë mendoj ndryshe. Xhaferi është i lidhur shumë me birin e tij Gafurrin dhe nuk besoj se do të vdes pa ardhur ai. Rreziku është atë ditë kur të vie Gafurri. Ashtu edhe ndodhi. Shoku im kishte pasur shumë të drejtë.

Ditët, muajtë, vitet kalonin dhe Gafurrit i erdhi dita që të lirohet edhe nga burgu i dytë. Lirohet me datën 14.9.1985. Të njejtën ditë, vdes babai i tij Xhaferi, posa e ndjeu në përqafim ngrohtësinë e birit të tij.

Me Gafurrin u takova të nesërmen, pasiqë me shokët që vepronim në ilegalitet konstatuam se kështu është më mirë, kinse nuk po merremi shumë me këtë temë. Në kokë kishte vendosur një plis të bardhë i cili e bënte edhe më burrëror dhe pasi e përqafova i shpreha ngushullime për babain e vdekur. Dhoma kishte qenë e mbushur me njerzë që vinin për ngushullime. Në mesin e

tyre nuk mungonin as "Danjollët", për të cilët i tregova Gafurrit, por edhe ai mu përgjigj se "i njoj nga feqka".

Pas lirimit të Gafurrit nga burgu, pak kohë ndejtëm bashkë sepse me 4 dhjetor 1985 u arrestova afër shtëpisë së Gafurrit, gjegjësisht te "Përroni i sejmenëve". Kur kalova rreth shtëpisë së tij me gjuhën e shpirtit përshpërita: "Gafurr, nuk u çmalla me ty. Zoti e din se kur do të shihemi përsëri". Gjatë vuajtjes së dënimit tim, vazhdimisht pyesja familjen time për hallet dhe shëndetin e Gafurrit. Në një rast nëna më tha: Gafurri është mirë, ka blerë një kalë të bardhë dhe po bartë dru. Kur shtrihesha në shtrat për të fjetur, parafytyroja të shtrenjtin Gafurr hypur mbi kalë të bardhë kah i ngjitet bjeshkëve të "Qeshmes së Shahes". Për një moment përjetoja dy gjëra: krenar që Gafurri nuk përulej dhe e dyta urrejtjen për gjithë strukturën e pushtetit titist.

GAFURRI KËRKON TË DREJTËN E PUNËS

Situata politike në Kosovë ishte e rëndë. Lidhja e komunistëve të Kosovës, si filialë e LKJ-së, nëpërmjet "platformës së tyre politike" i kishin shpallur luftë "irridentizmit" dhe "nacionalizmit" shqiptar. Krahas kësaj lufte, pas vitit 1981, pushtuesi kishte shpikur diferencimin politik i cili s'ishte gjë tjetër, pos luftë vëllavrasëse. Një i diferencuar i tillë ishte edhe Gafurr Loku.

I shtrënguar nga jeta, Gafurri kërkon të punësohet, kërkon të drejtën e punës. Por pushteti komunist i kohës për të burgosurit politik siç cekëm edhe më lartë, kishte ngritur pengesa nga më të ndryshmet, andaj Gafurri, nuk arriti të punësohet kurrë edhe pse punë kërkoi që nga viti 1979.

Në vazhdim do t'ju sjellim faksimile nga kërkesat e Gafurrit për punësim. Ai kërkonte çdo punë, madje edhe punëtor fizik edhe pse kishte të kryer tri vite të Fakultetit Ekonomik.

Gafurr Lokun, UDB-a sllave e cilësonte armik të shtetit. Nuk e linte kurrë të çetë, nuk kishte ditë që t'mos haste në ndonjë sylarosh të UDB-së, nuk kishte ditë që pushteti s'ia bënte me dije se po të përcjellim në mënyrë që ta izolojnë dhe në anën tjetër nuk i gjenin punë për krijuar krizë

СОЦИЈАЛИСТИЧКА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
СОБРАНИЕ НА ОПШТИНА ТЕТОВО
Секретаријат за внатрешни работи
Ку.бр.105
14-3-1982 год.

Врз основа на член 196 ст.1 од Законот за кривична постапка, Секретаријатот за внатрешни работи Тетово, донесува

Р Е Ш Е Н И Е

ПРОТИВ: ЉОКИ ЏАФЕР ГАФУР, по занимање студент, роден на 11-8-1949 година во с.Котлина, СО Качаник, СР Србија, со стан на улица "Иво Рибар - Лола" б.б. - Тетово.

СЕ ОПРЕДЕЛУВА ПРИТВОР

Притворот на именуваниот ќе се смета од 14-3-1982 година во 15,00 часот, кога е лишен од слобода.

Против ова решение именуваниот има право на жалба преку овој Орган до Советот на Окружниот суд во Скопје, во рок од 24 часа од предавањето на решението. Жалбата не го задржува извршувањето на решението.

О Б Р А З Л О Ж Е Н И Е

Поради постоење на основано сомнение дека Љоки Гафур сторил кривично дело "Непријателска пропаганда" од член 133 од КЗ на СФРЈ, а бидејќи постои бојазност дека именуваниот ќе се даде во бегство, согласно член 191 ст.2 т.1 од ЗКП, се реши како во диспозитивот.


ШЕФ НА ОДД ТЕТОВО,
Бекри Синани

Решението ми е предадено -
соопштено, на ден 14.03 1982 г.
во 21²⁵ часот.

Љоки

/потпис на притвор.лице/

Faksimil i vendimit për paraburgim i dt.14.3.1982



К П ДОМ „ИДРИЗОВО"


Домсна карта

ГАФУР
(име)


ЂОКУ
(презиме)

Р. Бр. 4824 К. Бр.

Letërnjoftimi i Gafurrit në burgun e Idrizovës



Faksimil nga lutja për bursë e datës 3.1.1979, ndërmarrjes Sharri" në Han të Elezit



Ngarkesë për prodhimin
e materialit ndërtimor SHA,
- Shërbimit për kuadro
Hani Elezit

Lutje

Të lartpërmendurit i bëjë
këtë lutje me qëllim që brenda muajdhve
të lejuara të më bëjë të mundur ndarjen
e një bursë për vazhdimin e studimeve të
Mëlegshme

Jamë student i viti të tretë III pranë
fakultetit Ekonomik në Prishtinë

Më parë jo lajmëro se mik jamë shfryt-
zues i asnjë bursë financiar studentesu
(kredi, burs etj). prandaj ndihma e juaj do të
jetë e mirëseardhur për vazhdimin e studimeve

Mbas me shpresë se lutja do të shqyrtohet
dhe do të merret vendim pa sa i përket
ndarjes së bursit.

Lutësi
Gafur Zeka
Hani Elezit

3 / 1979
Hani Elezit

Faksimil nga lutja për punë në "Sharr"
të Hanit të Elezit e datës 10.5.1989

ekonomike me të vetmen dëshirë që Gafurrin ta sjellin në depresione të thella shpirtërore. Por, Gafurr Loku nuk dinte se ç'është gjunjëzimi, ishte kalitur nga gurra e dashur e Atdheut i cili përpëlitej mes vdekjes dhe jetës, robërisë dhe lirisë. I përballoi edhe këto situata.

Flamurin e Çlirimit, brezat e trashëgonin krenarisht. Populli shqiptar i Kosovës me demonstrata të një pas njëshme arriti në një vetëdije më të konsoliduar politike. Grevat e minatorëve në "Trepçë" patën një jehonë të madhe, por edhe një tradhëti të thellë. Demonstratat e vitit 1989 për liri e demokraci shkallmuan edhe më shumë kalbësirën sllave. Komunistët e deridjeshëm hidhnin librezat e LKJ-së. Në skenë dolën partitë politike. Viti 1990 solli erëra të reja në rajon. Mospajtimet brenda federatës Jugosllave ishin të mëdhaja. Tanimë edhe brenda kësaj kreature të Titos, në skenë filluan të dalin kërkesa për çlirimin kombëtarë, si të sllovenëve, kroatëve. Në këto rrethana me 2 korrik të vitit 1990, në Prishtinë shpallet Pavarësia e Kosovës ndërsa me 7 shtator të të njëjtit vit edhe Kushtetuta e Kosovës, akte të cilat u përkrahën fuqimisht nga populli.

Pushtuesi serb, për të shkatërruar këto trende politike, mbylli fabrikat, shkollat, mjetet e informimit dhe natyrisht ngriti dhunën, gjithnjë duke synuar përkuljen e shqiptarit. Renegati Ali Shkuriu, duke menduar se nuk e dinë serbët, i preferoi që shqiptarëve duhet për t'ua zbrazur magjet, duke u mbështetur në thënien tonë të vjetër se "buka të qon në derë të hasmit".



Në vizitë shokut të posaliruar nga burgu i Idrizovës:
Rafi Halili me familjen e tij, në mes Gafurr Loku



Begracë: Në vizitë te Berat Luzha i posaliruar nga burgu
i Nishit, majtas: dëshmori Gafurr Loku.

Nën presionin e fuqishëm ndërkombëtarë, Serbia liroi të burgosurit politik shqiptarë që ende vuanin nga '81-shi. Krahas të burgosurve; në arkivole Serbia sjellte ushtarët kosovar me arsyetim se ata në kazermat sllave kishin bërë "vetëvrasje". Në varrimet e këtyre martirëve merrte pjesë një pjesë e madhe e popullit. Me 1 janar 1991 në Çupri të Serbisë vritet ushtari Izet Bushi ku edhe varroset në vendlindjen e tij me 4 janar në pjesëmarrjen e mbi 150.000 vetave. Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve ishte një tjetër madhështi e asaj kohe. U falën qindra e qindra gjaqe dhe në popull u krijua një atmosferë kombëtare.

Për çdo shok që lirohej nga burgu sllav, Gafurri kishte dëshirë së paku ta vizitonte. Kur Rafiu u lirua nga burgu i fundit u gëzua shumë, por kur e pa gjendjen e tij të rëndë shëndetësore, përjetoi dhembje të thellë. Një vizitë të tillë ia bëmë edhe Hydajet Hysenit në Përlepnicë të Gjilanit. Kur u futëm në dhomë, në këmbë u ngrit një plak dhe thirri:

- O mirë se vjen Gafurr Loku! - dhe iu hodh në përqafim. Ishte veprimtari i dalluar i atdheut Sejdi Kryeziu me të cilin Gafurri kishte qëndruar në burg viteve të 70-ta. Takime kishte edhe me Nejazi Korçën në Prishtinë, Berat Luzhën në Begracë, etj.

Arsimi shqip pas vitit 1990 u përball me gjendje të rëndë. Arsimdashësit që s'pranuan t'ia vejnë dryrin shkollës shqipe u përballën me gjendje të rëndë ekonomike. Për t'ua lehtësuar sado pak jetën arsimtarëve, në nivel Kosove ngriten Këshillat Financiar. Një Këshill i tillë

ngritet edhe në Han të Elezit dhe Gafurri ishte sekretar i këtij Këshilli. Derisa punonte si inkasant, shkonte derë më derë dhe nga familjet shqiptare kërkonte 5 DM për mësimdhënësit. Krahas kësaj ishte edhe kryetarë i SHBH "Nëna Terezë" në Han të Elezit duke ua zbutur sado pak gjendjen e rëndë skamnorëve. Ishte veprimtarë i KMDLNJ-së. Mori pjesë në paqësimin e shumë ngatrresave brenda shqiptare. "Duhet t'i pajtojmë shqiptarët mes vete. Të ndarë e të përçarë na don armiku. Ne s'duhet të luajmë lojën e tij" - porositte Gafurri.

Kur nga shtëpia bie në Han të Elezit-rrëfente Gafurri- ndodhin njëkohësisht dy ngjarje:

Ata që i kanë borgj Këshillit të Financave, ikin prej meje, ndërsa kur unë i shoh skamnorët dhe s'kamë për t'iu dhënë gjë, unë ikë prej tyre-shprehej si në shaka dëshmori, por në esencë tregonte një të vërtetë, sepse vërtetë situata ishte e tillë.

Lufta e filluar në Slloveni dhe më pastaj në Kroaci dhe kasaphanja që ndodhi në Bosnje e Hercegovinë ishin sinjifikative se edhe Kosova do të kalon nëpër një haraq të tillë. Politika ekspansioniste serbe gjatë zhvillimit të luftës në pjesët tjera në ish-Jugosllavi, ndaj Kosovës sillej me maturi, por situatën e kontrollonte në imtësi. Me kalimin e kohës dhe me afrimin e përfundimin e luftës në pjesët tjera të ish-Jugosllavi, Serbia në Kosovë shtrëngoi rrypat e dhunës policoro-ushtarake duke rrahur e torturuar të rinj e pleq mizorisht. Kërkimi i armëve në shtëpitë e shqiptarëve u bë punë e përditshme e

policisë gjakatare serbe dhe në kërkim të armëve që shqiptarët nuk i kishin, pësuan shumë njerëz në torturë.

Në muajin maj të vitit 1993, Gafurri më solli traktin e Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, i cili trakt u shpërnda nëpër Kosovë dhe e ftonte popullin për kryengritje të armatosur kundër pushtuesit serb. Alternativa kosovare traktin e tillë e sulmoi në të gjitha drejtimet, por ne e kuptuam se megjithatë brenda Kosovës ka forca që nuk pajtoheshin me status quon e krijuar që në kuptimin e thjeshtë don të thoshte as gjallë e as vdekur.

Kishte kohë që dëshmori Ismail Raka nga Kaçaniku merrej me bartjen e armëve ilegalisht dhe me grupin e Ismailit ishte i lidhur Bajram Dernjani dhe nëpërmjet Bajramit ishim të lidhur edhe ne. Në vjeshtën e 1993 Bajrami detyrohet të kalon në Gjermani. Të nesërmen në shtëpinë e Bajramit erdhën policia serbe, por tanimë Bajrami ishte jashtë rrezikut. Me 29 nëntor 1994 në shtëpinë e tij rrethohet dhe arrestohet veprimtari Ismail Raka dhe të njejtën ditë Ismaili vdes në torturë, por okupatorit serb nuk ia dhanë asnjë armë.


I përjetshëm qoftë kujtimi për dëshmorin Ismail Raka. Lavdi!

Konferenca e Dejtonit-thoshte Gafurri, përfundimisht ka fikur shpresat se çështja e Kosovës mundë të zgjidhet me mjete paqësore. Kosova do të lahet në gjakë, përfundonte Gafurri dhe

para nesh shtroheshin detyra nga më të rëndat.

Krahas represionit, në skenë filluan të dalin edhe aksionet e UÇK-së, njëkohësisht edhe dëshmorët e saj. Me 31 janar 1997 vriten tre pjestarët e UÇK-së: Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha. Kur një gazetë e Kosovës botoi fotografinë e dëshmorit Zahir Pajaziti, Gafurri e vendosi në murin e dhomës dhe thoshte: Ky është brezi që do të çliroj Kosovën.

Në varrimin e mësuesit Halit Geci me 28 nëntor 1997 në mesin e popullit u paraqitën tre pjestarë të UÇK-së duke ia dhënë Kosovës një demenzion tjetër politik, ndërsa revista ilegale "Çlirimi" kërkonte Ta Drenicizojmë Kosovën. Masakra serbe në Prekaz dhe rënia heroike e Komandantit Adem Jashari, Kosovën përfundimisht e hodhi në rrugë të lirisë dhe pranvera e 1998-ës malet e Kosovës i mbushi me luftëtarë të lirisë.



Gafurr Loku në përqafim të Ramë Bujës, 1.4.1996, Hani i Elezit

DRENICA, ÇERDHJA E LUFTËTARËVE TË LIRISË


Drenica e Ahmet Delisë, Azem e Shotë Galicës, Hasan Prishtinës, Shaban Polluzhës, Tahir Mehës..., s'kishte si t'mos e lindte Shaban, Hamzë e Adem Jasharin dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e cila fillimisht me njësitet e para sulmuese arriti t'i sfidoj rrjedhat politike të kohës. Masakra çetnike në Prekaz, Qirez, Likoshan..., ngriti në këmbë qindra e mijëra shqiptarë, jo vetëm në Kosovë, por në tërë trungun shqiptarë. Protesta në përkrahje të Drenicës kishte edhe në Han të Elezit dhe natyrisht në ballë të tyre ishte edhe dëshmori i Kosovës, Gafurr Loku.

Në protestat për përkrahje të Drenicës, mori pjesë edhe i biri i Gafurrit, Dritoni. Në një protestë e arrestojnë Dritonin dhe e torturojnë shumë rëndë. Atë ditë Gafurri ndodhej në Prishtinë. Kur erdh në shtëpi dhe e pa të birin e tij në lëkurë dashi, tha:

"Qëndro, biri im, qëndro. Çdo plagë që merret në shërbim të atdheut, është stoli. Kalojnë të gjitha. Atdheu ka plagë edhe më të mëdhaja".

Ngjarjet rrotulloheshin me shpejtësi të madhe. Ushtria Çlirimtare e Kosovës shtrihej gjithnjë e më shumë dhe një ditë qershori të vitit 1998, malet e Puseve të Nikës filluan të mbushen me luftëtarë të lirisë. Gëzim të madh kishte Gafurri. Të vetmen shpresë kishte luftën e

armatosur sepse "vetëm pushka - thoshte Gafurri, do t'i çlirojë trevat e pushtuara shqiptare". Luftën e armatosur e kishin edhe në programin e veprimtarisë së tyre ilegale që nga fillimi. Për këtë morën edhe armët nga gjimnazi i Tetovës dhe të njejtat i strehuan në Kalanë e Tetovës.



Në zyrën e Këshillit financiar në Han të Elezit, nga e majta Gafurr Loku me autorin e monografisë



Në zyrën e Këshillit financiar në Han të Elezit, nga e majta Gafurr Loku

KONTAKTET ME SHTABIN E UÇK-SË NË PUSET E NIKËS


19 Qershori i vitit 1998 në Han të Elezit solli kthesa. Kishte kohë që njësiti i UÇK-së në krye me juristin Rufki Suma vepronte në bartjen e armëve. Zbulimi i grupit dhe arrestimi i një pjese të grupit, lindi nevojën që pjesa e tjetër e shokëve të krijojnë bërthamën ushtarake ku si vend më strategjik qysh më parë kishin caktuar Puset e Nikës.

Kontaktet e para me shtabin e UÇK-së, Gafurri i kishte te Varret e Bushëve të Poshtëm, në mal. Kontaktet i mbanin natën, sepse siç thoshte Gafurri, ende duhet të sigurohen armë dhe Rufkiu duhet të ketë njerzë që do të lëvizin në organizimin e kësaj lufte. Nga shtëpitë tona kalonim Kodrën e Frashnit, binim nën urën e Kashanit, kalonim nëpër lumin Lepenc dhe kalonim në zonën luftarake të UÇK-së, komandant i së cilës ishte Rufki Suma. Kontakti i parë me uniformën e ushtarëve të UÇK-së në Puse të Nikës ishte emocional. Çdo herë kur shkonim në takime, merrnim armët e shokëve në krahun tonë, siç thoshte Gafurri: "Për t'u ambientuar" Për të siguruar armë shkoi edhe në Tetovë nga një lidhje që vinte nga Belgjika.


Gafurri kishte një respekt të madh për luftëtarët e lirisë. Ishte këmbëngulës për hapjen e

ambulancës humanitare "Nëna Terezë" në Han të Elezit. Duhet ta kemi, thoshte. Lufta ka nevojë për shumë gjëra, duhen mjek, barëra...

Në Shtabin e Puseve të Nikës shkoi disa herë. Mundohej të jepte sa më shumë këshilla. Gjithnjë interesohej për një organizim edhe më të madh. Respektonte sakrificën e familjes Brava që strehoi dhe ushqente luftëtarët e lirisë.



Pozicion lufte i UÇk-së në Puset e Nikës



Në këtë dhomë, ku njëherit ishte edhe Shtabi i UÇK-së në Puset e Nikës, qëndroi Gafurr Loku

VRASJA E DËSHMORIT

21 shkurt 1999. Ora 19,50. Natë e errët. Dy vetura të tip GOLF ndalen te dyert e shtëpisë së Gafurrit. Të parin e vrasin Dritonin pastaj Gafurrin. Pas vrasjes, makinat të stërmbushura me kriminel, kthejnë në drejtim të Hanit të Elezit për të vazhduar më tej në itinerarin e tyre. Ishte organizata paramilitare serbe "Dora e Zezë" e cila historinë e saj kriminale e shtrinë që nga viti 1912. Nga dora e saj janë vrarë shumë atdhetarë shqiptarë. Nga kjo dorë u vra edhe Gafurri me të birin e tij.

Gruaja e Gafurrit, Hasibja rreth momentit të vrasjes së burrit dhe djalit të saj, rrëfen:

"Ishte ditë e dielë. Nga shtëpia Gafurri doli në mëngjes. U nisë në drejtim të Hanit të Elezit. U kthye në orët e pasditës dhe më njoftoi se për darkë do të vjen babai im. Para darkës doli në shitoren e fshatit për të blerë cigare dhe kafe. U kthye në shtëpi menjëherë. Pasi ngrënëm darkën dhe derisa po pinim çaj, te dyert e oborrit u dëgjua një zhurmë. Gafurri doli me shpejtësi. Te dera e oborrit ishin vrasësit të cilët fytyrën e kishin të mbuluar me maska, kacafyteshin me Dritonin. Pjesa tjetër e vrasëtarëve e mbërthyen Gafurrin dhe tendencat e para kanë qenë për ta kidnapuar, por në pamundësi për ta bërë këtë, të parin e kanë vrarë Dritonin dhe më pastaj

Gafurrin. Me shpejtësi janë futur në kerret e tyre të cilët njërikishte pasur ngjyrë të bardhë, ndërsa i dytë ngjyrë tjetër. Mundë të ketë qenë i zi, i kuq ose i murrëm, por i bardhë si i pari nuk ka qenë. Kanë udhëtuar në drejtim të shtëpisë së Shaban Laçit ku kthejnë me shpejtësi dhe nisen në drejtim të Hanit të Elezit. Ngjarjen nga kati i dytë i shtëpisë e ka përcjellur edhe djali im i vogël Pajtimi".

Hamdi B.Raka (1922) nga Kaçaniku rreth vrasjes së Gafurrit dhe Dritonit, dëshmon:

"Shkova për të bujtur te dhëndrri im, pra te Gafurri. Atë ditë ai kishte qenë në Prishtinë. Nuk tregoi për natyrën e punës që kishte pasur atje, por as unë nuk e pyeta, por vetëm më tha se kam qenë në Prishtinë. Pasi ngrënëm darkën, kemi filluar të pijmë çaj dhe në ato momente u dëgjuan të rëna në dyert e oborrit. Menjëherë doli Dritoni duke menduar se mos është ndonjë mysafir. Pas tij doli edhe Gafurri. Pas pak çasteve u dëgjuan të shtëna tmerruese. Dola te dyert e oborrit. Dritonin e pashë të shtrirë në anën e djathtë, ndërsa Gafurrin në të majtën. Që të dy kishin vdekur në vend. Makinat u larguan me shpejtësi. Ishte natë tmerruese".

Rufki Suma, komandant i UÇK-së, në librin e tij dokumentar "Ushtria Çlirimtare e Kosovës në trevën e Hanit të Elezit" faqe 23, rreth lëvizjes së policisë dhe ushtrisë serbe të së njejtës ditë kur u vra Gafurri, shkruan:

"Në orët e paradites, dy kamion me ushtarë serbe dhe një eskavator ndalen para restoranit "RIO" (në Kashan, vërejtja e autorit). Ushtarët thyen dyert e lokalit dhe u futën brenda. Disa

ushtarë dhe njësi speciale u vendosën në fabrikën e "Kosovaplastit" në Han të Elezit".


Pse pikërisht këtë ditë ky mobilizim ushtarak?

Nga vetë kjo shihet se aksioni për vrasjen e Gafurrit ka qenë i përgatitur mirë dhe nga instancat më të larta policoro-ushtarake. Vendosja e ushtarëve serb në këto dy pika ishte e karakterit pozicionues sepse serbët kanë parallogaritur një kundërsulm nga njësitë e UÇK-së pas vrasjes së Gafurrit, andaj kanë planifikuar që Puset e Nikës të sulmohen nga këto dy pika, çka edhe ndodhi pas pak ditëve dhe pikat më të fuqishme sulmuese ishin pikërisht nga këto dy vende. Të nesërmen erdhën policia serbe për të bërë "ekspertizën". I morën kufomat dhe i dërguan në spitalin e Prishtinës.

Varrimi i dëshmorëve Gafurr e Driton Loku u bë në rrethana tejet të rënda me 24 shkurt të vitit 1999, në varrezat e fshatit Paldenicë. Në varrim morën pjesë mijëra vetë, përkundër pengesave që i bënte policia serbe. Fjalën e rastit e mbajti Zylbehar Hasallari nga Hani i Elezit, ndërsa nga Prishtina Binak Ulaj. E pranishme ishte edhe veprimtarja e dalluar Halime Morina. Krahas këtyre personaliteteve, në varrimin e Gafurrit, UDB-a sllave kishte dërguar edhe spiunët e saj për të përcjellur në imtësi varrimin, por në anën tjetër në këtë varrim merrnin pjesë edhe pjestarët e UÇK-së të veshur me rroba civile.

Në çastin kur po mbuloheshin me dhe dëshmorët në varrezat e fshatit Paldenicë, arriti shoku i tij më i afërt nga Tetova Rafi Halili dhe

me një grusht dhe Kosove u nda për herë të fundit me shokun e idealit, me shokun që për herë të parë ngriti flamurin, me shokun që kush e dinë se sa e sa tortura të barbarëve sllav përballuan mbi trupin e tyre, por krenar dhe besnik gjatë gjithë jetës së tyre.



Gafurr Loku i vrarë



Në sfond: Dyert e oborrit ku u vranë Gafurr e Driton Loku
Shigjeta 1, vendi ku u vra Gafurr Loku
Shigjeta 2, vendi ku u vra Driton Loku



e martë, 23 shkurt 1999

Hani i Elezit

U vranë babë e bir

Ushtria serbe po e minon Urën e Kaçanikut

Hani i Elezit, 22 shkurt

Nga NKMDLNJ në Han të Elezit u informuam se mbrëmë, rreth orës 20.15, para shtëpisë së tyre, në fshatin Paldenicë, u vranë Gafurr Xhafer Loku, nënkryetar i NKMDLNJ-së në Han të Elezit dhe djali i tij Dritoni. Sipas dëshmitarëve, ata u vranë nga disa persona të panjohur që dolën nga dy vetura.

Sipas dëshmitarëve që i dhanë informatën KMDLNJ-së, forcat ushtarake serbe po vendosin mina në urën në Grykë të Kaçanikut. Këtë po e bëjnë thuaja haptas. Preteksti i një veprimi të tillë nuk dihet.

I. Bela

Gazeta njofton vrasjen e Gafurr e Driton Lokut

Kronikë udhëtimi për Gafurrin

Me trup në Tetovë, shpirt në Prishtinë
Të vranë Gafurr Loku, s'të shtrinë.

Këmbët i kishe në ardhmëri
Veshët i kishe në Shqipëri
Me duar rroposje në pavdekësi
Sytë prore në Shqiptari.

Me trup në Tetovë, shpirt në Prishtinë
Të vranë Gafurr Loku s'të shtrinë.

Liria borxhin për ty e mban
Ku ta gjej kipcin o çoban
Ta nduk një majë nga muzeu i kujtimeve
Ta shkoqis një varg nga metafora e jetëvdekjes
Ta shtyej gurin e kufirit të zërit të heshtjes
Mirupafshim në kalanë e shpresës.

Fadil Curri, Dobrasin i Bujanocit, prill 1999

portret


Virtyte atdhetari

Djaloshi i Tetovës - Dëshmori i Kosovës

Gafurr Loku nga Kotlina e Kaçanikut e ngriti flamurin kombëtar shqiptar më 4 korrik të vitit 1968 te Fabrika e tekstilit në Tetovë. Këtë dhe birin e tij, Dritonin, e vranë më 21 shkurt të këtij viti para derës së shtëpisë së tij në fshatin Pal e Nikë të Hanit të Elezit

PUSHKA TOP U BË: Qetësinë e mbremjes së 21 shkurtit të këtij viti e prishen krismat e automatikut serb në fshatin Pal e Nikë të Hanit të Elezit. E dieli e kohshme për këtë ane u be kaq dera e zezë serbe vrau babë e bir, Gafurr e Dritoni Loku, kur po rrecheshin në bisedë familjare me vëllezërit, përkatësisht gjyshin e nipërit mysafir nga Kaçaniku. Një nga panjohur kishte ikur nga dera e oborrit. Se pari doli Dritoni, pastaj Gafurri dhe që të dy i prei automatiku me befasi. Babë e bir ndenin nga plumbat para derës së shtëpisë. Për pak te koçe i shpëtoi edhe tim botër i Gafurit.

Vrasja E Gafurr Lokut nga ana e shërbimit sekret serb nuk ishte akt i rastit, si mund të ndodhte nga ndonjë polic i dehur në rrugë, por i qëllimshëm, i parapërgatitur. Ate e vranë në shtëpinë e tij, sepse ia njihnin virtytet dhe bëmat e tij luridashese që nga djalëria në Tetovë e deri në ditët e fundit. Në të vërtetë kush ishte Gafurr Loku, rrefime të cilat po i shpeshojnë duke u mbështetur në bisedat e shumta me të dhe nga deshmitë e ofruara nga një familjar i tij, të cilët nuk po iu përmendim emrin, meqë gjendet në gjendje delikate jete në burgjet e Serbisë.



Nisma patriotike e vetëmbajtur u bënë nga UDB-ja, megjithese ajo i ndiqte edhe bisedat e tij.

Në mars të vitit 1982, forca te mëdha policore i ishin vërsulur shtëpisë së tij ne Tetovë. Ky nuk gjendej aty. Miqtë e tij ia bejnë me dije në Kaçanik per këte. Policët u kthyen, dhe e gjurmuan dhe me 13 mars të këtij viti, përsëri e arrestojne. I marrin edhe shumë shtrita magnetofonike, mezime nga komentet e "Zërit te popullit" rreth çështjes së Kosovës. Ne këto kohë e burgosin edhe vellain e Gafurrit, Kadri Lokun, Veli Beqirin, Vexhi Hafiun dhe Rushit Nesimin. Arrestohen edhe anetarev e organizates "Kushtrimi i Lirisë

Desha të shtoj dicka per bashkëfshatari kundrejt këtij stoiku, vrasjet e ma nbaj tij ndjen si pike ne dash. Kur ta bera me dije se edhe për të me ka pyetur policia magjistrale, qëte u përgjigja, se këto ditë e befason se edhe disa ne Tetovë i kishin pyetur për të. Kështu vepron policia me parcelen te shqiptar, mendjemadhe.

Bisedat e fundit që i bëra me Gafurrin ishin ne nëntë të këtij viti. Ne mbremje ishte prezent te nje kusherire nga Prishtina se kishte dale Gafurri. Dreqin se do te vinte dhe ai bir [illegible]. Ne tendosmi, pasdarke [illegible]

RIVARRIMI I DËSHMORËVE GAFURR E DRITON LOKU

Me 21 shkurt 2001, në dyvjetorin e vrasjes së dëshmorëve Gafurr e Driton Loku bëmë rivarrimin e tyre në varrezat e dëshmorëve në Puse të Nikës. Mëngjezi i 21 shkurtit shokët dhe familjen e dëshmorëve i gjeti pranë varreve në fshatin Paldenicë.

Filloi zhvarrimi i dëshmorëve. Punohej paralelisht në të dy varret. Shokët e tij ushtarë të UÇK-së, tani pjesëtarë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës pikëllueshëm vazhdonin hapjen e varrit... hjekën dërrasat, filloi të zbardhëte pëlhura e bardhë e dëshmorit thuajse e kishe varrosur dje edhe pse nga varrimi i parë kishin kaluar dy vite të plota. Te koka e të shtrenjtit Gafurr kishte rrjedhur një pikë gjak ende i freskët, dëshmi se për t'u fituar liria duhet gjaku i bijëve më të mirë.

Në rivarrimin e dëshmorëve morën pjesë mijëra vetë. Erdhën shokë nga Struga, Shkupi, Tetova, Kaçaniku, Ferizaj, Gjilani, Prishtina... Pikërisht në mesditën e 21 shkurtit trupat e pajetë të Gafurrit dhe birit të tij njëzet vjeçar Dritonit ia falëm tokës së shtrenjtë. Fjalën e rastit e mbajti shoku i tij ish i burgosuri Mehmet Ballazhi dhe njëherit zv.komandanti i Brigadës

164 "Gafurr Loku", ndërsa në shtëpinë e kulturës në Han të Elezit po këtë ditë u përkujtua dita e krismës së pushkës së parë meqë rast komandanti i Brigadës 164 të UÇK-së, Rufki Suma ndër të tjera tha:

"Sot bëmë rivarrimin e dëshmorëve Gafurr e Driton Loku. Nderojmë dhe falënderojmë familjen e dëshmorëve që na e plotësuan dëshirën për rivarrim... Dëshmorët janë letërnjoftimi i atdheut. Atdheu pa dëshmorë vdes".



Momente nga rivarrimi



Momente nga rivarrimi

Të nderuar pjesmarrës!

Ushtria Çlirimtare e Kosovës në trevën e Hanit të Elezit u formua me 19 qershor të vitit 1998 fillimisht me pak njerzë. Numri i ushtarëve u ngrit me shpejtësi dhe në pjesën e dytë të luftës u formua Brigada 164 e UÇK-së e cila mori emrin e dëshmorit Gafurr Loku.

Baza ushtarake e UÇK-së në Puse të Nikës jo vetëm që dha dëshmorë në zonën e saj luftarake, por ushtarët e saj ranë në fushbetejat e Kosovës. Dëshmori Veli Ballazhi me gjakun e tij të njomë vaditi malet e Pashtrikut, ndërsa Imri Curri në Koshare la gjakun e tij amanet që kufi ndërmjet shqiptarëve të mos ketë. Krahas kësaj, baza ushtarake e Puseve të Nikës dhe pjesa tjetër e Brigadës në fshatin Gjurgjedell të komanduara nga Emrush Suma ishin kanalet e rëndësishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nga këto kanale depërtoi armatimi për njësitë e UÇK-së, uniforma ushtarake, vullnetarë për luftën çlirimtare si dhe u bë bartja e ushtarëve të plagosur

për në Maqedoni. Nëpër këtë pikë luftarake kaluan edhe udheheqësit tanë të luftës si: Hashim Thaçi, Ramë Buja, Gjenerali Agim Çeku, eprori i Shqipërisë Adem Shehu, Shukri Buja, Ilmi Reçica, Hysen Shahini "CD"-eja e shumë të tjerë.

Të nderuar pjesmarrës!

Sot bëmë rivarrimin e dëshmorëve Gafurr e Driton Loku, andaj edhe krismën e pushkës së parë të 26 shkurtit, për këtë vit e ndërlidhëm me dyvjetorin e vrasjes mizore të Gafurrit dhe djalit të tij Dritonit. Nderojmë dhe falënderojmë familjen e dëshmorëve që na e plotësuan dëshirën për rivarrim. Dëshmorët presin nga të gjallët, andej ne po mundohemi t'i nderojmë duke i tubuar në një vend sepse pamarrë parasysh se ku u vranë, kishin një qëllim dhe një ideal-çlirimin e Kosovës së shtrenjtë. Shprehur në gjuhën politike, dëshmorët janë letërnjoftimi i atdheut. Atdheu pa dëshmorë vdes, ndërsa një popull që si kujton bijtë e tij rënë për liri, robëria do t'i përsëritet.

Gjaku i Gafurrit, Dritonit, Xhemsedinit, Nuriut, Imerit, Suadit, Veliut, Imriut dhe gjaku i dëshmorëve të Kosovës na obligon që edhe më shumë të punojmë për realizimin e dëshirës së tyre - Pavarësinë e Kosovës.

Lavdi dëshmorëve të kombit!

21 shkurt 2001, Hani i Elezit

Komandanti i TMK-së
Rufki Suma

Fjala e rastit e Mehmet Ballazhit zv.komandant i Brigadës 164 "Gafurr Loku" të UÇK-së, në rivarrimin e dëshmorëve Gafurr e Driton Loku.

Të nderuar pjesmarrës!

E nderuara familje e dëshmorëve!
Të nderuar ushtarë e ushtarakë!

Jemi tubuar në Puset e Nikës për të bërë rivarrimin e dëshmorëve Gafurr e Driton Loku të cilët u vranë me 21 shkurt të vitit 1999 nga ana e sigurimit serb në orën 19,50 minuta në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit. Vrasje që pikëlloi thellë popullin shqiptarë.

Dëshmori Gafurr Loku u lind në vitin 1949 në Kotlinë të Kaçanikut. Filloren e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në gjimnazin e Tetovës. Kishte të kryer tri vite të Fakultetit Ekonomik në Prishtinë.

Aktiviteti i tij kombëtar fillon që herët. Me 4 korrik të vitit 1968 ku së bashku me Rafi Halilin, veprimtarin e dalluar të Tetovës, ngritën flamurin kombëtar shqiptar në Fabrikën e Tekstilit në Tetovë, në çastet kur edhe në Kosovë punohej me të madhe për organizimin e demonstratave të nëntorit të vitit 1968. Që nga ajo ditë e deri sa u vra i shtrenjti Gafurr, veprimtarin për çlirimin e atdheut nuk e ndali kurrë. Organizohet në veprimtarinë ilegale të kohës dhe së bashku me shokun e tij Rafi Halilin, formojnë organizatën ilegale, qëllimi i së cilës ishte Bashkimi kombëtarë e territorial i atdheut të

shtrenjtë, të cilin konferencat e Berlinit, Londrës dhe Parisit e kishin ndarë e coptuar si është më së keqi. Bien në kontakt me redaksinë e revistës "Shqipëria e Re" që botohej në Tiranë dhe jo vetëm që e lexonte vetë, por atë ua jepte në lexim edhe shokëve të tij.

Për t'u çliruar nga pushtuesi serbo-malazezo-maqedon së bashku me Rafi Halilin morrën armët nga gjimnazi i Tetovës dhe fillimisht i strehuan në shpellat e rrethinës së Tetovës. Aktivitetin e tyre e shtojnë në shkrimin dhe shpërndarjen e pamfleteve në të cilat ftohej popullata shqiptare në Maqedoni për çlirim kombëtar.

Arrestohet në Prishtinë me 21 shtator të vitit 1972. Hetimet për 5 muaj me radhë zhvillohen në burgjet e Maqedonisë ku torturohet rëndë. Me 21 janar të vitit 1973, Gafurri me shokët e tij nxirret para Gjykatës së Qarkut në Shkup dhe dënohen:

Rafi Halili 7 vjet burg
Gafurr Loku 5 vjet burg
Rushit Nesimi 5 vjet burg
Elmaz Ademi 4 vjet burg
Ajet Ademi 2 vite e 6 muaj burg.

Gafurr Loku burgun e vuan deri në ditën e fundit pa gëzuar asnjë ditë amnesti. Pas daljes nga burgu martohet me Hasibe Rakën nga Kaçaniku. Torturat e rënda në burg bënë që Gafurri për një kohë të qëndrojë i shtrirë në spitalin e Prishtinës, por kurrë pa iu nda veprim-

tarisë atdhetare. Kontaktonte me shumë njerëz dhe me këdo që kontaktonte mbjellte farën e çlirimit të atdheut. Arrestohet përsëri me 12 mars të vitit 1982 nga UDB-a e Kaçanikut dhe Gjykata maqedone sërish e dënon me burg në kohëzgjatje prej 3 vite e 6 muaj. Pra, dëshmori Gafurr Loku gjithsejt mbajti 8 vite e 6 muaj burg dhe të tërin e mbajti në Idrizovë. Ishte shok burgu i dëshmorit Rexhep Mala, Shpëtim Pollazhanit, Xhafer Shatrit, Sejdi Kryeziut, Naip Tanushecit e shumë e shumë të tjerëve. Pas viteve të 90-ta ishte sekretar i Këshillit për Financa në Han të Elezit, nënkryetar i KMDLNJ-së si dhe kryetar i Shoqatës Humanitare "Nëna Terezë". Nuk ishte anëtar i asnjë partie politike sepse Gafurri besonte thellë se çlirimin e atdheut do ta bëjë vetëm gryka e pushkës.

Me lindjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës këtu në Han të Elezit, Gafurri bashkëpunon dendur me Shtabin e UÇK-së. Me Gafurrin kontaktonim këtyre maleve ku jemi ne sot, pra edhe në këtë fushë ku po e bëjmë rivarrimin e tij së bashku me birin e tij njëzet vjeçar, Dritonin, i cili me një grup shokësh në janarin e vitit 1999 shkon si ushtarë i UÇK-së në Shalë të Drenicës në brigadën e dëshmorit të Grykës së Llapushnikut "Imer Alushani".

Vrasja e dëshmorëve Gafurr e Driton Loku është një pikëllim i madh dhe njëkohësisht një humbje e madhe për popullin shqiptar, gjaku i tyre rënë në tokën e Arbërit është amaneti për brezat pasardhës dhe shembull se si jetën duhet kushtuar atdheut.

Sot, vëllezërit tanë dëshmor, Nuri Bushi, Xhemsedin Suma, Veli Ballazhi, Imri Curri, Suad Brava dhe Imer Vila këtu pranë nesh, janë edhe më të lumtur që në varrezat e dëshmorëve u sollën dëshmorët Gafurr e Driton Loku sepse ata ranë për të vetmin ideal, çlirimin e atdheut, për të cilin derdhën gjakun e tyre, për të cilin dhanë gjënë më të çmueshme - Jetën.

Dëshmorët i bashkoi Kosova, i bashkoi pushka, tani po i bashkon edhe varreza. Ata nuk duhet të qahen, me ata duhet të krenohemi sepse edhe Allahu i madhërishëm thot: Ata janë të gjallë, por ju nuk e dini.

Të nderuar pjesmarrës!
Të nderuara familje të Dëshmorëve!
Të nderuar ushtarë, shokë të dëshmorëve!

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte dhe mbeti krenaria e popullit shqiptar, flamurtarja e lirisë, gjëja më e shtrenjtë dhe më lavdiplotja e shekujve të fundit. Komandanti i saj legjendar Adem Jashari dhe dëshmorët tjerë rënë fushëbetejave të Kosovës janë letërnjoftimi i historisë sonë kombëtare, andaj i përjetshëm qoftë kujtimi për ta.

Lavdi dëshmorëve të lirisë!
Rroftë populli shqiptarë!

Në ditën e dytë të Krishtlindjeve në pushkën me tre vrima të Hanit të Elezit

Babë e bir pushojnë së bashku me trimat e lirisë

Nëntë shqiptarë vëllezërish kanë lindur trima që i dolën zot ndiheut. Dëshmorët e rënë fushëbetejave të Kosovës janë letërnjoftimi i historisë sonë kombëtare



Një grusht dhe Kosove për dëshmorin nga e ëma

Besnik DEMI

Në Han të Elezit

U shënua dyvjetori i krismës së parë

Gafurr dhe Driton Loku, babë e bir, u rivarrosën në Varreza të Dëshmorëve në Pustenik

EKREM RAKA

HAN I ELEZIT, 22 SHKURT - Babë e bir, Gafurr (1949) dhe Driton Loku (1979), u rivarrosën në Varreza të Dëshmorëve në fshatin Pustenik, të mërkurën në mesditë.

"Gafurri dhe Dritoni u vranë nga pjesëtarët e sigurimit shtetëror serb, më 21 shkurt të vitit 1999, në fshatin Paldonicë", nënvizoi në fjalën e rastit Mehmet Ballazhi, epror i TMK-së së Hanit të Elezit.

U paraqitën edhe Bajram Kryeziu, epror në Zonën VI të TMK-së, Xhabir Xharku, nënkryetar i KK-së së Kaçanikut dhe Shpëtim Pollozhani (nga Maqedonia), bashkëvuajtës i Gafurrit në Burgun e Idrizovës së Shkupit.

Ndërkaq, në emër të familjes Loku, për pjesëmarrje në rivarrim të pranishmëve të shumtë falënderoi Shefket Loku, vëlla i Gafurrit.

Po të mërkurën, në orën 16:00, me një manifestim të bërë në ish-sallën e kinemasë, në Han të Elezit, u shënua dyvjetori i krismës së parë në këtë anë. Rivarrimi i dëshmorëve të mësipërpërmendur ishte shkak që dyvjetori i kësaj ngjarjeje të shëndohej 5 ditë më herët. Pati, ndërkaq, fjalë rasti nga orgnaizatori dhe aso përshëndetëse nga mysafirët, ndërsa u shfaq edhe një program modest artistik.

Në kuadër të manifestimit në fjalë u bë edhe promovimi i 2 ditarëve të luftës, të autorëve Rufki Suma, komandant i TMK-së së Hanit të Elezit dhe Mehmet Ballazhi, zëvendëskomandant.

"Këto dy libra dhe shumë të tjera si këto që janë botuar kohët e të fundit, më se miri i demantojnë ata të cilët para luftës thonin se po na e prishin rehatinë njerëzit që nuk dinë shkrimlexim", tha gjeneral-major Rrustem Mustafa, (komandant i Zonës VI të TMK-së.

Gazetat për rivarrimin e dëshmorëve Gafurr e Driton Loku



Hasibe Loku, gruaja e dëshmorit

NË VARREZAT E DËSHMORËVE TË HANIT TË ELEZIT

U rivarrosën dëshmorët Gafurr e Driton Loku

Me rastin e dy vjetorit të vrasjes së tyre (babë e bir), si dhe të krismës së pushkës së parë në këtë trevë, u mbajt edhe një manifestim tjetër, në të cilin mori pjesë edhe gjeneralmajori Rrustem Mustafa-Remi

Kaçanik, 22 shkurt

Në varrezat e dëshmorëve në Han të Elezit, që gjenden në fshatin Puset e Nikës, dje u bë rivarrimi i dëshmorëve të kombit, babë e bir, Gafur dhe Driton Lokut, të cilët u vranë më 21 shkurt 1999 në fshatin Paldonicë, nga forcat policore ushtarake serbe. Për jetën ,dhe veprimtarinë atdhetare të Gafurr Lokut (1949) foli Mehmet Ballazhi epror i TMK-së, nga Hani i Elezit. Aktiviteti i tij, tha Mehmet Ballazhi,filloi qysh heret, më 4 korrik 1968. Gafurr Loku, bashkë me Rafi Halilin, ngriti flamurin kombëtar në Fabrikën e Tekstilit në Tetovë. Që nga ajo kohë e deri në ditën e vrasjes së tij, Gafurri nuk e ndali aktivitetin e tij për çlirimin kombëtar. Për shkak të këtij aktiviteti, ai u burgos dy herë dhe vuajti dënimin prej gjithësejt 8 vjet e gjysmë burg. Me lindjen e UÇK-së, Gafurr Loku, kishte kontakte të dendura me shtabin e UÇK-së. Ai, megjithate, nuk i takoi asnjë partie. Ishte anëtar i Këshillit të Financimit, nënkryetar i NKMDLNJ-dhe kryetari i SHHB "Nëna Tereze" në Han të Elezit. Driton Loku (1979),në janar të vitit 1999, bashkë me një grup shokësh, tha Mehmet Ballazhi, ishte i kyçur në UÇK, pikërisht në Shalë të Drenicës.

Në emër të Zonës së VI të TMK-ës dhe komandantit të saj, gjeneral majorit Rrustem Mustafa-Remi, të pranishmit i përshëndeti Bajram Kryeziu epror i lartë i TMK-së. Me nga një fjalë rasti u paraqitën edhe Xhabir Zharku, ish komandant i Brigadës "Agim Bajrami" të UÇK-ës në Kaçanik (tani nënkryetar i KK të Kaçanikut), dhe Shpëtim Pollozhani, nga Struga, shok burgu i Gafurr Lokut. Në emër të familjes, pjesëmarrësit i përshëndeti Shefket Loku, vëllau i dëshmorit Gafurr Loku. Mbi varrezat e dëshmorëve u vunë edhe kurora lulesh.

Po këtë ditë, në Han të Elezit, u mbajt edhe një manifestim tjetër, kushtuar dy vjetorit të vrasjes së Gafurr e Driton Lokut, pastaj të krismës së pushkës së parë në këtë trevë (26 shkurt 1999), për të cilat ngjarje foli Rufki Suma , komandant i TMK-së në Han të Elezit, si dhe u promovuan dy libra (ditar të luftës), njëra e Rufki Sumës, kurse tjetra e Mehmet Ballazhës (zëvendëskomandant i TMK-së në Han të Elezit).

Në sallën e kulturës ku u mbajt ky manifestim, ishte i pranishëm edhe gjeneralmajori Rrustem Mustafa - Remi, komandant i zonës së VI të TMK-së. U dha edhe një program kulturo-artistik.

D. SHEHU

Gazetat për rivarrimin e dëshmorëve Gafurr e Driton Loku

Në rivarrimin e Gafurrit morën pjesë edhe shokët e tij nga Tetova e Struga. Në emër të tyre fjalën e mori shoku i burgut Shpëtim Pollozhani.

Të nderuara motra dhe vëllezër!
Të nderuar familjarë!
Të nderuar ushtarë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, ushtria e ardhshme e Kosovës.

Jam Shpëtim Pollozhani nga Struga. Shok i burgut i Gafurrit, Rafiut, Rushitit, Ajetit dhe të tjerëve.

Që në fillim të viteve 1970, në çelitë e burgjeve të Maqedonisë, dhe në veçanti të Idrizovës, ja merrnin masën dhe ia pritnim teshat Jugosllavisë. Teshat për fat të mirë ia premë mjaft ngusht të cilat duhet t'i mbaj edhe një kohë. Gjithashtu me Gafurrin dhe shoqërinë e tij, ishim edhe themelues dhe bashkëveprimtarë të organizatës ilegale politike Kushtrimi i Lirisë dhe bisedat tona të para ishin, trojet etnike dhe liria e popullit shqiptarë. Kjo veprimtari vazhdoi deri në ditët e fundit derisa gjallëronte Gafurri në këto troje dhe unë mendoj, se ideali i tij dalngadalë po çlirohet dhe fati i shqiptarëve në trojet e robëruara i ngjanë kohës që e kemi sot; Një qiell pak me diell, pak me re, pak ftohtë, por përsëri jep shpresë se pranvera është afër.

Ideali nuk shuhet kurrë dhe për atë njeriu duhet të luftojë. Lufta jonë nuk ka të ndaluar dhe nuk do të ndalohet dersa të realizohet ideali i Gafurrit, i Rafiut dhe i shokëve të tjerë. Ideali i tyre është: Perëndia në Ballkan ka krijuar një baraspeshë biologjike dhe dersa kjo baraspeshë të mos vihet në vend nuk do të ketë qetësi në

këto troje. Kjo baraspeshë është: Në Ballkan duhet të ketë një shtet me 7 milion shqiptarë, 7 mil. grekë, 7 mil. bullgarë dhe 7 mil. serb.

Ju falemnderit dhe u takofshim në raste më të mira.

Fjala përshëndetëse e Shefket Lokut, vëlla i Gafurrit, pjesëmarrësve të rivarrimit me dt.21.2.2001 në Varrezat e Dëshmorëve në Puset e Nikës.

"Vëllezër dhe motra, ushtarë e ushtarakë, miq dhe mysafir të nderuar.


Ju përshëndes përzemërsisht në emër të familjes së dëshmorëve Gafurr e Driton Loku. Përshëndes familjet e dëshmorëve të rënë për lirinë e Kosovës, ushtarët e Brigadës 164 të UÇK-së e cila mban emrin e dëshmorit Gafurr Loku si dhe mbarë qytetarët nga Tetova, Struga dhe qytete tjera të Kosovës, duke ju falënderuar përzemërsisht për pjesmarrjen tuaj në rivarrimin e bijëve tanë".

Shtëpi për familjen e dëshmorit


Populli i kësaj ane, në shenjë respekti për dëshmorin Gafurr Loku dhe birin e tij Dritonin, në Han të Elezit, fëmijëve të dëshmorit i ngritën një shtëpi. Shtëpia, bashkëshortes së Gafurrit gjegjësisht nënës së Driton iu dorëzua me 29 gusht 2001 në prani të shumë qytetarëve dhe në atë përurim merrnin pjesë struktura politike nga komuna dhe Prishtina.



Shtëpi për familjen e dëshmorit



Moment pune të Gjeneralit Rrustem Mustafa - Remi në shtëpinë e dëshmorit Gafurr Loku



Gjenerali Rrustem Mustafa - Remi në mesin e ushtarëve të TMK-së në një çast pune në ngritjen e shtëpisë së familjes së dëshmorit.



Komandant Remi në shoqërim të komandant Rufki Sumës pranë vëllezërve Ballazhi .

NJË PROPOZIM QË DUHET TË PËRKRAHET

NJË DITË KREMTE PËR TË GJITHË DËSHMORËT E KOSOVËS

Për luftëtarët e rënë gjatë luftës së fundit çlirimtare të anës së Hanit të Elezit me rrethinë u zgjodh të kremtohet një ditë, data 29 gusht, e cila tani e tutje do të jetë edhe Dita e Dëshmorëve, që do të kremtohet për çdo vit.

Hani i Elezit, 30 gusht

Pasditja e djeshme për qytetarët e Hanit të Elezit ishte një festë. Ishte ditë kur bijtë dhe bijat e kësaj ane u përgjaken për lirinë e Kosovës. Ishte dita kur familjet e dëshmorëve krenohen me bijtë e tyre, prandaj edhe mbajnë kokën lartë duke qëndruar krenar, se nga gjaku i tyre rodhi liria, se nga gjaku i tyre do të rrjedhë çdo e mirë për ne dhe për brezat që do të vijnë. Prandaj, në shenjë nderimi dhe respekti për ta, ceremoniali i kësaj dite filloi me homazh dhe vënie kurora lulesh të Varret e Dëshmorëve në lagjen e Davëve në Pusnik, aty ku edhe ishin celulet e para të UÇK-së së kësaj ane. Ushtarë e ushtarakë të TMK-së nga Kosova dhe brigadat e saja në Kaçanik dhe në Han të Elezit si dhe familjarë e asociacione të tjera shoqërore e komunale vunë kurora me lule dhe bënë homazh dhjetë varreve ku pushojnë ëmbël trupat e dëshmorëve të lirisë së kësaj ane, të cilët kishin luftuar jo vetëm në rrethinën e Hanit të Elezit, por edhe më gjerë në Kosovë e jashtë saj.

Shënimi kryesor i kësaj dite u mbajt në kazermën e TMK-së të brigadës 164 "Gafurr Loku" në praninë e një numri të madh qytetarësh jo vetëm nga Hani i Elezit po edhe më gjerë. Në atë ambient të rrallë të një kazerme të tillë, pas parakalimit të brigadës dhe këndimit të Himnit Kombëtar, fjalën e rastit e mbajti Rufki Suma, komandant i brigadës 164 "Gafur Loku" dhe njëri nga luftëtarët më të zotit të njësitit të parë të UÇK-së të këtij rrethi. Ai në fjalën e tij tha: "Më 19 qershor 1998 në fshatin Puset e Nikes u formua njësiti i parë ushtarak, i cili me kalimin e kohës u rrit derisa në pjesën e dytë të luftës u formua brigada 164 e UÇK-së, e cila mori emrin e Gafurr Lokut. Brigada 164 e UÇK-së u shtri në dy anët e lumit Lepenc, duke mbuluar hapësirët gjeografike të Hanit të Elezit. Kjo zonë ushtarake ishte edhe baza e furnizimit të njësiteve ushtarake të luftës, duke filluar nga armatimi, municioni, uniformat, bartja e të plagosurve etj. Pjesëtarët e UÇK-së të Hanit të Elezit luftuan jo vetëm në këtë anë, por edhe më gjerë në Kosovë, përkatësisht në Koshare". Duke i përshëndetur pjesëmarrësit Rufkiu vazhdoi: "Një popull që i kujton dëshmorët kurrë nuk ka mort, sepse dëshmorët janë palca e kombit. Si të tillë mbeten në historinë tonë të pavdekshme. Se lufta jonë ishte e drejtë dëshmon fakti se ajo u përkrah edhe nga ana e ndërkombëtarëve të forcave të NATO-s, të cilat pas luftës ndihmojnë dhe do të ndihmojnë transformimin e UÇK-së në TMK.

29 Gushti është Dita e Dëshmorëve.

Të nderosh dëshmorët, do të thotë të nderosh atdheun

Të nderosh ata do të thotë të nderosh Atdheun, sepse për atdhe edhe dhanë më të shtrenjtën jetën", përfundoi Suma, fjalën e tij të rastit, e cila u prit me pietet të lartë.

Në këtë të kremtë madhështore pati edhe të pranishëm nga Zona e Gjashtë e TMK-së në Gjilan, ku zoti Bajram Kryeziu, foli në emër të kësaj zone dhe të ushtarakëve të saj, duke thënë: "Janë disa momente kulminante të historisë sonë që ndryshuan rrjedhat e jetës. Ndër ato momente është epopeja e vitit 1968, epopeja e vitit 1981, epopeja e lavdishme e UÇK-së. Kështu trimat e vendit i vunë themelet e shtetit të Kosovës në mesi netë cilëve përmendi emrat e të rënëve dëshmorë të Hanit të Elezit e më gjerë". Në manifestimin në fjalë ishin të pranishëm edhe përfaqësues të strukturave të ndryshme komunale e më gjerë, të cilët morën pjesë edhe me fjalën e tyre si Ramë Buja, Xhabir Zharku, Xhemil Ballazhi, etj. Me këtë rast vlen të përmendet edhe botimi i një poeme, siç u tha, për dëshmorët nga i përvujaturi Shaban Çupi, me titull: "Nga gjaku i tyre rrjedh liria", ku nga një ekzemplarë iu shpërnda familjeve të dëshmorëve dhe disa të ftuarve. Disa vargje të kësaj poeme i recituan nxënëset e SHM "Dardania" të këtij qytetiti. Kjo pjesë e këtij manifestimi u mbyll me programin e bukur autokton të SHKA "Sharri" i këtushëm.

Shtëpia për dëshmorët dhuratë nga populli

Në vazhdën e këtij manifestimi, pikën kulmore e arrin përurimi i shtëpisë për dëshmorët babë e bir Gafurr dhe Driton Loku, të cilët i vrau dora e zezë serbe në shtëpi të tyre, më 21 shkurt 1999. Për kontributin e tyre dhënë lirisë, populli i kësaj ane dhe asociacione të ndryshme shoqërore e private arritën që familjes së Gafurr e Driton Lokut ti ndërtojnë një shtëpi të bukur në qendër të Hanit të Elezit. Para shtëpisë përuruese, për jetën e Gafurrit foli Rexhep Shkreta një ndihmëtar i madh i këtij objekti, i cili përkujtoi rrugën jetësore e përvuajtëse të Gafurrit me shokë për liri. Çelësat dhe dokumentacionin komplet të kësaj shtëpie gruas së Gafurrit ia dorëzoi kryetari i KK-së të Kaçanikut Tehit Baka, kurse shiritin përurues e preu Ramë Buja, duke e futur të parën në shtëpi nënën e dëshmorit Gafurr. Me këtë rast u falenderuan të gjithë donatorët fizikë dhe material që dhanë kontributin e tyre për ndërtimin e kësaj shtëpie me mirënjohje të veçantë.

Ramadan Asllani

Shtypi rreth manifestimit të 29 gushtit,2001

NGA ALBUMI




Gafurr Loku, foto e vitit 1967



Gafurr Loku, student
në Prishtinë



Pas daljes
nga burgu i parë,
majtas Gafurr Loku



Martesa me Hasibe Rakën nga Kaçaniku



Sarajevë, 17.5.1980, majtas në këmbë Gafurr Loku

UNIVERSITETI I KOSOVËS NË PRISHTINË

FAKULTETI EKONOMIK

Nr. 12274

Prishtinë 4 III 1982

Nr.i indeksit 6/11988

Sipas lutjes së Gafur Zeqiri nga Kollina dhe në bazë të nenit 171 të Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative në përputhje me dispozitat e Statutit të Fakultetit Ekonomik në Prishtinë lëshohet kjo

ÇËRTIFIKATË

Gafur Zeqiri i ka lindur më 11.08.199_ në Kollinë RS Kosovë është student e i - e rregullt, me korespodencë pranë Fakultetit Ekonomik të Prishtinës dhe ka të regjistruar semestrin e _____ dhe ka të dhëna këto provime:

VITI i I

1.Bazat e filozofisë marksiste	nota 7	(shtatë)
2.Ekonomia politike I	nota 6	(gjashtë)
3.Ekonomike e OPB-I	nota 6	(gjashtë)
4.Matematika I	nota 6	(gjashtë)
5.Gjeografia ekonomike	nota 7	(shtatë)
6.I drejtë	nota 6	(gjashtë)
7.Gjuhë e huaj	nota 6	(gjashtë)
8.Bazat e përgj thshme të mbroj.popullore I	nota 6	(gjashtë)

VITI i II

1.Kontabilitet I	nota 8	(tetë)
2.Sociologjia	nota 8	(tetë)
3.Ekonomia politike	nota 6	(gjashtë)
4.Statistika	nota 6	(gjashtë)
5.Matematika	nota 6	(gjashtë)
6.Ekonomia e PB II	nota 6	(gjashtë)
7.Gjuhë e huaj	nota 6	(gjashtë)
8.Bazat e mbr tjes popullore II	nota 6	(gjashtë)

Viti i III

1.Teknologjia	nota 6	(gjashtë)
2.Organizimi organizatave të PB	nota 6	(gjashtë)
3.Kërkimet operacionale	nota	
4.Financat	nota	
5.Gjuhë e huaj Frëngjisht	nota 7	(shtatë)
6.Ekonomika e Bujqësisë	nota 6	(gjashtë)
7.	nota	
8.	nota	

Viti i IV


1.Planifikimi i zhvillimit ekonomik	nota	
2.Marrëdhëniet ndërkombëtare ekonomike	nota	
3.Kibernetika në ekonomi	nota	
4.Zhvillimi i mendimit ekonomik	nota	
5.Teoria e çmimeve	nota	
6.	nota	
7.	nota	
8.	nota	

Certifikata mund t'i përdorët për

Taksat nga numri tarifë dhe 4 e ligjës mbi taksat administrative është paguar dhe në përshtetshë anuluar në mënyrë të rregullt.

SEKRETARI I FAKULTETIT TË NDUKAËVE

Çertifikatë e provimeve të dhanura lëshuar
nga Fakulteti Ekonomik i Prishtinës me 4.3.1982
disa ditë para arrestimit të dytë



Gafurr Loku në mes, Paldenicë, 1994



Protesta kundër dhunës serbe në Han të Elezit.
Në këtë protestë ishte edhe Gafurr Loku

KËSHILLI QËNDROR PËR FINANCIM I KOSOVËS
KËSHILLI KOMUNAL PËR FINANCIM HANI ELEZIT
(komuna)

DËFTESË KF Nr 165041

Me të cilin dëshmohet se personi juridik-fizik GAFUR LOKU
(emri i personit juridik-fizik)

nga ____ rruga PALOGNICA nr. 2

ka paguar akonto në emër të kontributit BAZA + PGN 2... për periudhën

Korrik-Tetor/97 në shumën 32 D.M tridhjetedy DM
(me shkronja)


Më 17.12.97

(emri dhe mbiemri)


KËSHILLI PËR FINANCIM HANI ELEZIT

(inkasanti)

Fletëpagesë për Këshillin e Financimit, shkruar nga vetë Gafurr Loku më 17.12.1997



Gafurr Loku, 24.5.1992


UÇK
USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS
GAFURR LOKU
1949 - 1999
DRITON LOKU
1979 - 1999



Rafi Halili në moshën rinore

"Ku është pushka, vërtet është varri, por është edhe nderi, krenaria, liria... Armiku nuk ndalet me fjalë por me pushkë, qoftë ajo edhe e vjetër, edhe e ndryshkur, por derisa e vret armikun është shumë i mirë"

Rafi Halili

Për të kompletuar sado pak veprimtarinë e dëshmorit Gafurr Loku, ne do të sjellim rrëfimin e shokut të tij Rafi Halili sepse aty ku ishte Rafiu, aty ishte edhe i shtrenjti Gafurr. Duke mësuar për shokë e tij, mësojmë edhe për veprimtarin e Gafurrit.

Në vazhdim do të sjellim një intervistë të Rafi Halilit dhënë gazetarit Demir Rushiti për gazetën "Epoka e Re" të datës 7 gusht 2001.

Bisedë me Rafi Halilin, disident dhe ish i burgosur politik

Rafi Halili, i lindur më 1950 në Tetovë, është disident dhe i burgosuri politik me stash më të gjatë qëndrimi nëpër burgjet maqedone. Rafiu, si edhe shumë shqiptarë tjerë nga Maqedonia, këto ditë është duke e bërë jetën e refugjatit në Prizren. Rafiu një burrë mesatar, me një karakter të fortë e energjik, pranoi me knaqësi të flasë, kur kuptoi se ky bashkëbisedim do të botohet në të përditshmen "Epoka e Re".

"Është e vetmja gazetë në trojet shqiptare të cilën e lexoj me kënaqësi dhe i përshëndes ata djelmosha që me nxjerrjen e kësaj të përditshme, duke mos lëvizur asnjë millimetër nga tabani kombëtar, po japin kontribut të çmueshëm në informimin e drejtë dhe objektiv të popullatës shqiptare, e veçmas të atyre nga Maqedonia", u shpreh Rafiu në fillim të bisedës.

Dënimi i parë që në moshën 17 vjeçare

Në vitin 1967, si nxënës i vitit të dytë në shkollën e mesme, bashkë me Gafurr Lokun (dëshmor i luftës së fundit) në vendin e quajtur "Udha e Fabrikës" në Tetovë, vendos flamurin shqiptar. E arrestojnë dhe e torturojnë rëndë, duke e dënuar me 20 ditë burg, që do t'i mbante me kusht nëse brenda një viti e përsërit veprën. Ky është edhe fillimi i një jete revolucionare të Rafi Halilit, pjesën më të madhe të së cilës do ta kalojë nëpër burgjet sllavomaqedone. Më 22 dhjetor 1968 organizohet demonstrata e parë në Tetovë. Edhe Rafiu, së bashku me disa shokë iu bashkua turmës së demonstruesve.

"Në fillim brohoritnim 'Tito-Fadil', ndërsa kur e pamë se këto parulla nuk u bënin gjithaq përshtypje policëve maqedonë, filluan të brohoritim, Rroftë Shqipëria, "Rroftë Enver Hoxha", ... gjë që i tmerroi policët dhe pushtetarët e atëhershëm", kujton Rafiu.

Rafiu ishte ndër më të zëshmit në këtë drejtim. Kështu, disa herë radhazi turma e demonstruesve e kapin në duar dhe e ngrenë lartë, ndërsa një polic shqiptar e urdhëron të dalë nga turma dhe ia kujton se emri i tij tashmë është i njohur për policinë. Përta ndjekur Rafiun, i kishin vënë detyrë njëfarë fotografi shovinist me emrin Sreçko Janevski, i njohur për të këqijat që iu ka bërë shqiptarëve. Në një moment, kur komandanti i policisë së Tetovës përpiqet që demonstruesve t'ua marrë flamurin, Rafiu e godet atë me një shufër hekuri në kokë dhe e alivanos.

Demonstratat sa vijnë e shtohen, ndërsa polícët gjithnjë e më brutalë.

"Me tre shokë nga Kosova, Gafurr Lokun, njëfarë Idrizi dhe një tjetër që s'mund t'ia kujtojë emrin filluan ta sulmojnë me gurë e shufra hekuri policinë. Ishim të provokuar nga fotografi shovinist Janievski, i cili në sytë tanë e dogji flamurin shqiptar. U betuam që këtë fotograf do ta likuidonim", rrëfen Rafiu dhe shton se pas përfundimit të demonstratave u arrestua menjëherë dhe u dënua me 30 ditë burg, nën akuzë se ka brohoritur "Rroftë Enver Hoxha", "Poshtë tradhtarët"..., për nxitje të urrejtjes nacionale, thyerje të objekteve publike e private, etj. Ky ishte dënimi i dytë me burg të cilin e mban në Tetovë. Atëbotë Rafiu ishte nxënës i klasës së tretë në shkollë të mesme. Dënimi i dytë brenda një viti bën që Rafiu të përjashtohet nga shkolla. Pas bredhjes nëpër disa qytete të Kosovës me synim që ta vazhdoj shkollimin, më në fund, me ndihmën e disa profesorëve dhe miqëve që e njihnin Rafiun dhe veprimtarin e tij, regjistrohet në gjimnazin e Kamenicës, ku përfundon vitin e tretë.

Ishte planifikuar ekzekutimi i Sreçko Janievskit, atentat ndaj kryetarit maqedon Kërsto Cërvenkovskit, Rankoviqit dhe Titos

Pas përfundimit të shkollës së mesme, në vitin 1971, Rafiu regjistrohet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ku vazhdon aktivitetin e tij patriotik. Këtu, me disa shokë, themelon grupin revolucionar me emrin "BASHKIMI" dhe angazhohet në

formimin e celulave të para të këtij grupi në fshatrat: Shipkovicë, Xhepçishtë, Gajre, Zhelinë, Poroj, Reçicë, etj. "Bashkimi" kishte të hartuar programin me anë të së cilit kërkohej-realizimi i të drejtave nacionale, sociale, politike e kulturore të shqiptarëve në Maqedoni dhe trojet tjera shqiptare në Jugosllavinë e atëhershme të Titos: vendosja e flamurit; përdorimi i gjuhës shqipe në administratë në qytetet ku jetojnë shqiptarët; shkollimi në gjuhën shqipe në nivel të mesëm, të lartë dhe fakultet; krijimi i shoqërive kulturo-artistike me programe kombëtare; punësimi sipas proporcionit të strukturës nacionale; barazia sociale e të punësuarve, si dhe përfaqësuesit shqiptarë në forumet shtetërore të flasin dhe shkruajnë në gjuhën shqipe. Gjithashtu, në program ishin paraparë edhe metodat të cilat duhet të përdoren për realizimin e këtyre synimeve. Fillimisht, nëpërmjet shpërndarjes së pamfleteve, materialeve propagandistike, librave të ndryshme që shkruanin kundër shtetit titist revizionist jugosllav, me qëllim të sensibilizimit të popullit shqiptarë për t'u ngritur në greva e demonstrata. Nëse nuk bënin punë këto metoda, atëherë ishte paraparë edhe rruga e armëve.

"Me Gafurr Lokun, Baki Ymerin, Rushit Nesimin, Elmaz Ademin, Ajet Ademin dhe dy nxënës nga Zhelina, vodhëm disa pushkë në gjimnazin e Tetovës, por nuk na hynë në punë, sepse i kishin plumbat prej druri", kujton Rafiu.

Me 1 maj 1972, me rastin e festës së punëtorëve, në disa qytete të Maqedonisë, Rafiu me shokët e lartëpërmendur i vendos flamujt kombëtarë. Në disa raste gjatë kryerjes së aksionit madje

pati edhe konflikte të armatosura me policinë. Gjithashtu, ishte planifikuar edhe ekzekutimi i Sreçko Janievskit në shenjë hakmarrje për djegien e flamurit, ndërmarrja e masave ndëshkimore ndaj policëve kriminelë maqedonë, si dhe ishte planifikuar të bëhet atentat ndaj kryetarit të atëhershëm maqedon, Kërsto Cërvenkovskit, ndaj Rankoviqit dhe ndaj Titos.

Gjatë kësaj pariudhe, Rafiu shumëzon dhe shpërndanë gazetat "Ylli" dhe "Shqipëria e Re", të cilat i vinin atij rregullisht nga Shqipëria.

Me 21 shtator 1972, policia e arreston tërë grupin... Rafiun bashkë me Gafurrin, UDB-ja e Tetovës i kapi në Prishtinë, ndërsa të tjerët në Tetovë. Është kjo burgosja e tretë me radhë e Rafiut. Më 1 janar 1973, grupi nxirret para gjyqit. Gjykata e Qarkut në Shkup, Rafiun e dënon me 7 vjet, Gafurrin me 5, Rushitin me 5, Elmazin me 4,5, Ajetin me 2,5, ndërsa të tjerët me disa muaj burgim. Gjatë afër katër muaj në hetime, në Burgun e Qarkut në Shkup, Rafiu maltretohet rëndë fizikisht dhe psikikisht. Pas dy muajsh, nga torturat e mëdha, sëmuret nga veshkët dhe këmbët, kështu që e dërgojnë në spital, ku qëndron afro një muaj nën përkujdesje të shtuar policore.

Rexhep Mala ka qenë një burrë i fuqishëm, me karakter të fortë dhe shumë aktiv

Nga 7 vjet, sa ishte i dënuar, Rafiu i mban 6, në burgun e Idrizovës. "Ishte një burg tmerri, një mizerie", kujton Rafiu. Në shenjë mospajtimi me persekutimin fizik e psikik, me injorimin nacional e

njerëzor që u bëhej të burgosurve, Rafiu futet 6 herë në grevë urie. Në këtë burg, ai njihet me disa nga organizatorët e demonstratave të '68-tës në Kosovë, si Xhafer Shatrin, Rexhep Malën, Hasan Dërmakun, Shaban Xheladinin etj. "Rexhep Mala ka qenë një burrë i fuqishëm me karakter të fortë dhe shumë aktiv", thotë Rafiu duke përkujtuar se me të ka vazhduar bashkëpunimin edhe pas daljes nga burgu.

"Ai ishte një burrë i gjatë, i fuqishëm dhe shumë i drejtë. Anonte ngapak nga Balli, sepse babën e kishte patur ballist. Ishte shumë intelegjent, edhe pse kishte mbaruar vetëm një shkollë të mesme. Vrasja e tij më ka tronditur pa masë. Gjatë kohës sa ishim bashkë në burgun e Idrizovës, Rexhepi më ka dalë shumë zot", tregon Rafiu.

Memorandumin në emër të 500 mijë shqiptarëve të Maqedonisë, dërguar krerëve të shtetit jugosllav.

Rafiu tashmë ishte përcaktuar në rrugën e lirisë. Ai nuk trembej më as nga torturat e as nga burgu, i cili atij ishte bërë "shtëpi e dytë". Menjëherë pas daljes nga burgu, inkuadrohet në Organizatën Marksiste-Leniniste të Shqiptarëve në Jugosllavi, organizatë kjo që nxirrte organin e saj me emrin "Liria". Formon degën e kësaj organizate në Tetovë dhe i ve emrin "Kushtrimi i Lirisë". Vendos pamflete në rajonin e Tetovës dhe përpiqet që me një grup të organizojë demonstrata në Tetovë, në shenjë përkrahjeje të demonstratave studentore të vitit 1981 në Prishtinë.

Bashkë me Bejtullah Ademin, Xhevat Ademin, Agim Kasamin, Naser Belulin, Arif Belulin (tani i vrarë) organizon celulën e "Kushtrimit të Lirisë" në fshatin Reçicë. Gjithashtu, organizon edhe celula tjera si në Vicë (me Resi Abdurrahmanin e Xhevat Xhemilin) në Shipkovicë (me Vehbi Beqirin e Remzi Beqirin), në Tetovë (me Ahmetali Veliun, Fatmir Rexhepin dhe Alirami Veliun). Brenda një kohe të shkurtër, arrin që celula të tilla të formoj madje edhe në Strugë. Në këtë kohë, Rafiu shkruan një memorandum (500 mijë Shqiptarët e Maqedonisë Kërkojnë dhe Protestojnë - vërejtje SH.Ç.), prej 7 faqesh, në emër të 500 mijë shqiptarëve të atëhershëm. Ky memorandum dërgohet me anë të postës. Disa nga këta ekzemplarë të memorandumit arrijnë në vendin e destinuar, kurse një pjesë e tyre kapët. Në këtë Memorandum kërkohej bashkimi i trojeve shqiptare në Jugosllavi me shtetin amë, Shqipërinë, duke iu përmbajtur parimit "Komb-Vend-Shtet", duke përmendur në mënyrë kronologjike të gjitha luftërat që kanë bërë shqiptarët që nga koha e Skënderbeut, pastaj në vitin 1878, 1912, 1945, etj. duke lavdëruar rendin socialist të Shqipërisë, PPSSH-në, etj. Në Memorandum kërkon, gjithashtu, që të bihet vendim për ndryshimin e kufinjëve në bazë të zbatimit konsekuent të parimit të demokracisë proletare (o me të mirë, o me të keq-vër. R.H.), të drejtën e shkëputjes së njeriut ndaj njeriut dhe kombit ndaj kombit... Në organizatë inkuadrohen edhe anëtarë tjerë të familjes së Rafiut, e sidomos e ëma dhe motra, të cilat japin një kontribut të çmueshëm në shpërndarjen e Memorandumit si dhe të pam-

fleteve nëpër Tetovë dhe qytete tjera të Maqedonisë, por edhe në Kosovë. Atëbotë Rafiu ishte në marrëdhënie pune si shërbëtor në shkollën fillore "Liria" në Tetovë. Policia që kishte nuhatur aktivitetin e Rafiut e kërkon për ta arrestuar, mirëpo, në mars të vitit 1981, Rafiu arratiset. Për afro një muaj bënë jetën e kaçakut në male, një kohë strehohet te daja i tij në fshatin Sellc, pastaj te fqinjët dhe tek një shok i tij. Gjatë kësaj periudhe, Rafiu ka bërë jetë ilegale me lëvizje të kufizuara, pa e ndërprerë aktivitetin.

"Shumë herë jam veshur me rroba të femrave, me qëllim që të shkoja nga një vend në tjetrin", rrëfen Rafiu dhe shton se gjatë kohës sa ka qenë në arrati, disa herë ka pasur përleshje të armatosura me policinë në lagjen "Murat Baftjari" në Çarshinë e Epërme të Tetovës. Pas çdo hedhje pamfletesh, alarmohej i gjithë qyteti. Policia e dinte se nga kush hudheshin këto pamflete dhe bënte presion në familjen e Rafiut, duke e keqtrajtuar nënën e tij, pastaj gruan me tre fëmijët e vegjël: Rinën 8 vjeçe, Shqipërikuqen 3 vjeçe dhe Shqipedëshmorin 2 vjeç, për shkak të emrave të tyre. Ia arrestojnë gjithashtu edhe vëllain, Vexhiun dhe e dënojnë me 5 muaj burg, përshkak të shpërndarjes së pamfleteve. Gjatë kësaj kohe, Rafiu kishte vënë kontakte me Rexhep Malën dhe shokët tjerë nga Kosova, nga të cilët kishte marrë premtimin se do t'sjellin armë për të organizuar rezistencë.

Me 6 qershor 1982 kthehet fshehurazi në shtëpi për të marrë vesh në i kishin arritur armët dhe hetohet nga spiunët e UDB-së. Në shtëpi hynë rreth orës 22, në mbrëmje, kurse rreth orës 01 pas

mesnate rethohet e tërë lagja e tij në Çarshinë e Epërm. Fillimisht policët hudhin gurë në dritare dhe kërkojnë që të dorëzohet. Më pas e thyejnë derën e shtëpisë dhe futen brenda në dhomën e pleqëve...

"E kisha mbushur revolen dhe pata vendosur që i gjallë të mos bie në duar e tyre. Derën e kisha lënë hapur dhe po prisja momentin për të gjuajtur. Nëna më tha mos bir se do të të vrasin...", kujton Rafiu atë natë tmerri të para 20 viteve, kur ky me një revole në dorë, po bëhej gati të luftonte kundër qindra policëve të armatosur deri në dhëmbë. Në atë moment, policia fillon t'i rrahë brutalisht prindërit e Rafiut, duke u kërkuar atyre që të tregojnë se ku e kanë të birin. Rafiu nuk mund të durojë më dhe briti me të madhe "Lëshone shtëpinë se iu vrava!" Rreth 15 minuta mbretëroi një heshtje e pakuptimtë, kurse më pas policia filloi të shkrepë rafale automatikësh në drejtim të shtëpisë. Rafiu i përgjigjet zjarrit me zjarr. Me plumbin e parë godet një polic. Pastaj, me dy plumba tjerë qëllon edhe dy policë tjerë, që kishin ardhur për t'i dalë në ndihmë kolegut të tyre. Të frikësuar nga plumbat e Rafiut, të cilët nuk shkonin bosh, policët tërhiqen duke gjuajtur nga poshtë pa kontroll. Në tërheqje e sipër marrin peng edhe babain e Rafiut, duke e përdorur atë si mburojë... I gjendur në një pozitë të tillë kur rrezikohej ta vriste të atin, Rafiu për një moment ndërpret krismat. Atë çast, një plumb që vjen nga jashtë, e qëllon atë në gojë dhe i del nga qafa.

"Filluan të më erren sytë dhe duke e ndier se do të më vrasin, e mësova gruan se si ta përdor rev-

olen. Më ishte mbushur goja me gjak dhe sytë më bënin terr. Në dhomë hyri një farë polici me emrin Bexhet dhe në gjuajtje e sipër më qëlloi me një plumb në ije. Gruaja i drejtoi atij revolen, por polici ia rrëmbeu dhe e rrëzoi për tokë. Polici më tërhoqi zvarrë dhe më futi në shtëpinë e xhaxhait ku pasa pak e sollën babain duke e rrahur, për të pohuar se jam i biri i tij...", kujton Rafiu ato momente tmerri të natës së 6 qershori 1982.

Rreth orës 4 të mëngjesit, Rafiun e plagosur e dërgojnë në repartin kirurgjik të Spitalit të Tetovës dhe e hudhin pa ndjenja për dysheme, ndërsa personeli mjekësor i tëri ishte përqëndruar në ofrimin e ndihmës tre policëve që kishte plagosur Rafiu. Duke e ndier veten të braktisur dhe në gjendje gjysmë i vdekur, Rafiu e ngjyen gishtin me gjakun e tij që i dilte shkumë nga goja dhe në dyshemenë e betonit të spitalit e shkruan "Rafi", "Bashkim" dhe "RPSSH"! Një mjeke shqiptare, me emrin Mihrie (e cila edhe sot punon si gjinekologe në spital -vër. R.H.), kur e vëren se çfarë shkruante me gjak, iu thot policëve maqedonë "go tepajte" (mbytne!)...

Pas ndihmës së parë, e nisën për në Spitalin e Shkupit me automjet të policisë. Në rrugë e sipër, në sheshin e Tetovës, ku ishin mbledhur shumë qytetarë për të marrë vesh se çfarë kishte ndodhur gjatë luftimeve të mbrëmshme, policia e hap derën e makinës duke ua ekspozuar atyre Rafiun gjysmë të vdekur, me plagët që po i kullonin gjak dhe duke iu kërcnuar atyre se kështu do të pësojë çdonjëri që përpiqet të ngrejë dorë mbi policinë... Në Spitalin e Shkupit, mjekët angazhohen për t'i ofruar ndihmë.

"Policët i nxorën jashtë dhe vendosën roje. Ma pastruan gjakun që më ishte ngjizur në gojë... gjuhën e kisha të këputur e dhëmbët e thyer, gjak më rrithte vazhdimisht edhe nga plaga tjetër në ije. Më dhanë disa injeksione dhe plot 24 orë isha pa vetëdije" kujton Rafiu dhe shton: "Kur u këndella nga koma, provova të ngritem, por ishte e pamundur, sepse më kishin lidhur për krevati. Më dukej vetja si pa kokë dhe pa këmbë, ishte vërtetë një gjendje interesante. Përpiqesha ta prek kokën me duar, për ta vërtetuar a e kam me vehte por ishte e pamundur sepse i kisha duart e lidhura. Ashtu edhe këmbët nuk i ndieja se i kam të miat!"... Pas pak ditësh, i sjellin një vendim me të cilin Rafiu akuzohej se kishte plagosur një polic.

Nuk kam plagosur një, por kam vrarë tre dhe do t'ju vrasë të gjithëve, sapo të shërohem pak, iu thotë Rafiu policëve. Ata nga inati e kapin për fyti dhe përpiqen ta ngulfatin, por në atë moment hyn në dhomë një motër medicinale dhe policët e lëshojnë. Pas 19 ditësh qëndrimi në spital, mjeku kryesor i thotë Rafiut "ti je një armik i shtetit".

"Etika mjekësore na detyron që fillimisht të të mjekojmë, e më pas ta marrësh dënimin e merituar. Sot mbaron shërimi yt", i kish thënë ai. Edhe pse ende i pashëruar, me plagët që vazhdimisht i kullonin gjak, Rafiun e dërgojnë në burgun hetues ku heq të zezat e ullirit.

"Vinin me radhë për t'u hakmarrë policët që i kisha sulmuar gjatë kohës së demonstratave. Nga pjesa tjetër e pavionit të burgut dëgjoheshin britma grash. "Ja ku po i dhunojmë gratë dhe motrat tuaja. Kemi sjellë këtu magjupë për t'ua dhunuar nënat, gratë, motrat. Ju këtë e meritoni", më

thoshin policët, rrëfen Rafiu dhe shton: "Vërtetë, pos meje i kishin burgosur edhe nënën, motrën dhe gruan. Nuk i durova dot ato britma dhe fillova t'i mëshoj derës me sa fuqi që kisha. Vjen për t'më qetësuar një polic, të cilin e godita dhe e rrëzova për dysheme! Turren edhe 7-8 policë tjerë drejtë meje... Të burgosurit tjerë të cilët kishin përcjellë situatën, fillojnë t'u mëshojnë dyerve"...

Ky rebelim i Rafiut bëri që ai të rrihet mizorisht nga policët sllavomaqedonë, si dhe i shtohet edhe një akuzë tjetër për tentimvrasje të policit në burg. Gruan dhe të atin ia lëshojnë nga burgu, kurse nënën dhe motrën vazhdojnë ta mbajnë brenda. Pas një kohe i vijnë për vizitë në burg babai dhe bashkëshortja. Policët e kishin urdhëruar që të fliste me ta vetëm maqedonisht. Gruaja nuk e njihte maqedonishten dhe Rafiu i flet në gjuhën shqipe, duke i thënë asaj se është e lirë të ndahet nga ai, në mënyrë që së paku gruaja të shpëtoj nga torturat. Këto fjalë të shqiptuara në shqip, i kushtuan shtrenjtë Rafiut. Në praninë e më të afërmëve e rrahin në mënyrë më mizore duke e përgjakur dhe duke e shtrirë përtokë pa ndjenja...

Nuk e respektoj kushtetutën tuaj

Në gjykatë e dërgojnë pas 5 muajve të tmerrit të kaluar në burgun hetues. Ndërkohë e akuzojnë edhe për bashkëveprim me "grupin armiqësor" në përbërje prej Xhevat Ademit, Bejtullah Ademit, Resi Abdurrahmanit, Naser Behlulit, Agim Kasamit, Ali Kasamit... Rafiun nuk e lejojnë të flasë. Dy fjalë të vetme që arriti t'i thotë përpara trupit gjykues

ishin: "Nuk e respektoj kushtetutën tuaj" dhe "Lexoni tekstin e Memorandumit që kam shkruar unë". Fillimisht e dënojnë me vdekje, e më pas më 15 vjet burg, pasi që i dalin në.mbrojtje shumica nga afro 20 dëshmitarë sa i kishin sjellë në gjykatore. Edhe anëtarët e tjerë të "grupit armiqësor", ndër të cilët ishin edhe e ëma që nuk dinte shkrim-lexim si dhe e motra Hiremja, u dënuan me shumë vite burg (Bejtullahu me 14, Xhevati me 12 e ëma me 7, e motra Hiremja me 5, Resiu si i mitur, gjithashtu me 5, ndërsa të tjerët nga 10 deri në 3 vjet). Ishte ky dënimi i katërt i Rafiut. Dënimin e vuan në burgun famëkeq të Idrizovës, ku për 4 vjet torturohet e terrorizohet në mënyrën më mizore, duke u rrahur nga i gjithë personeli i burgut, madje, edhe nga mjeku dhe drejtori. Është interesant se drejtori i burgut gjatë kësaj periudhe ishte emëruar gjykatësi që e kishte dënuar Rafiun në vitin 1972! Për 3 vjet rresht mbahet i izoluar në një qeli stacionari, ku bën 4 greva urie (10, 15,14 dhe 28 ditëshe). Gjatë kësaj periudhe mjekët i japin injeksione me përmbajtje siliciumi dhe ia helmojnë gjakun, duke i shkaktuar sëmundjen e sheqerit dhe të veshkëve, nga të cilat edhe sot vuan. Për shkak të rrebelimit dhe futjes në grevë, atij ia rrisin dënimin edhe për një vit, madje në një moment përpiqen edhe ta ekzekutojnë. Pas disa ndryshimeve në politikën jugosllave dhe maqedone të asaj kohe, Rafiun e kapë amnestia dhe ia falin 1,5 dhe një herë tjetër 3,5 vjet burg, mirëpo përkundër mbarimit të burgut, atë nuk e lirojnë. Disa shokë dhe bashkëveprimtarë të Rafiut, organizojnë në Tetovë demonstrata të fuqishme në kërkim të lirim-

it të Rafiut dhe të burgosurve të tjerë shqiptarë, të cilët e kishin përfunduar afatin e burgimit dhe mbaheshin ende nëpër burgje. Demonstrata të tilla organizohen edhe në Zvicër. Duke u gjetur përballë një sfidimi serioz, autoritetet maqedone detyrohen që Rafiun ta lirojë. Kështu, pas plot 10 vjetësh të kaluara prapa grilave, më 7 qershor të vitit 1992, derisa turma ende po demonstronte nëpër rrugët e Tetovës, Rafiu lirohet dhe me një makinë policie, nga një rrugë anësore dërgohet drejt e në shtëpi, duke i vënë masa të forta sigurie dhe duke e kufizuar çfardo kontakti të tij me njerëz. Këtë izolim të tij edhe në shtëpi, që mund të merret si edhe një burgosje tjetër e Rafiut, policia maqedonase e bëri duke qenë e vetëdijshme se gjatë gjithë atyre viteve të kaluara nëpër burgje, nuk arriti që t'ia venitë shpirtin e tij revolucionar...


Krismat e para të pushkëve të lirisë nga djelmoshat dhe vajzat e UÇK-së, Rafiun e gjejnë në një shtëpizë barinjësh sipër Tetovës, ku ai që disa vjet i vetëdijshëm se vetëm me grykën e pushkës mund të realizohen aspiratat kombëtare, kishte ngritur një istikam dhe kishte hartuar planin e goditjes së kriminelëve. Mirëpo në këtë drejtim nuk kishin ndenjur duarkryq as forcat policoro-ushtarake maqedonase, të cilat kishin ndier rrezikun që iu kanosej nga Rafiu. Menjëherë pas luftimeve që u zhvilluan në kalanë e Tetovës, Rafiun forcat maqedonase bëjnë përpjekje ta likuidojnë duke gjuajtur disa herë radhazi në drejtim të kolibes ku ai ishte strehuar...

Në fshatin Gajre takohet me dy ushtarë të UÇK-së, të cilët e marrin me vete dhe e shpiejnë në

Shtabin kryesor. Pas disa ditë qëndrimi atje, për shkaqe shëndetësore, Rafiu detyrohet të vijë në Prizren...

"Vetëm rruga e luftës, vetëm gryka e pushkës shpiejnë drejt realizimit të aspiratave tona kombëtare. Ku është pushka, vërtetë është varri, por është edhe nderi, krenaria, liria", thot Rafiu duke shtuar se kurrë nuk mundë të vritet dëshira e natyrshme e një populli për të jetuar bashkë.

"Armiku nuk ndalet me fjalë por me pushkë, qoftë ajo edhe e vjetër, edhe e ndryshuar, por derisa e vret armikun është shumë e mire! Edhe liderët e partive, në momentin që ka krisur pushka, do të duhej të linin mënjanë politikën dhe të rreshtohen përkrah luftëtarëve të lirisë, se vetëm ashtu fitohet nderi. Maqedonia nuk ka ushtarë dhe armatim të mjaftueshëm për t'u përballuar me ne. Dëshira jonë për liri na bënë shumëfish më të fortë se ata. Ata janë duke organizuar mercenarë të ndryshëm. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Evropa, duhet t'i vejnë embargo armësh dhe ta çarmatosin ushtrinë maqedone, e jo UÇK-në. Madje këto shtete duhet ta armatosin UÇK-në, sepse populli shqiptarë në Maqedoni ka nevojë për liri, e jo maqedonët! Ata duhet të ndërhyjnë për ta dëbuar ushtrinë dhe policinë maqedone e serbe nga trojet tona, e jo të venë protektorat. Ata duhet të vendosin kufinj realë, aty ku i kemi ne shqiptarët, që nga koha e Lidhjes së Prizrenit. Nuk duam dhe nuk lejojmë krijimin e llogoreve dhe burgjeve në tokën tonë, siç bëri jugosllavi. Bashkimi i trojeve tona me shtetin amë është demokraci, kurse e kundërta është fashizoidem, reaksion, errësirë..."



Shaban Çupi është i lindur më 2.1.1961 në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit. Ka kryer SHLP-në mësimin klasor në Prishtinë. Punon si mësimdhënës në fshatin e lindjes.

Për veprimtari politike u dënua dy herë dhe ka mbajtur gjashtë vite burg.

Në vitin 2001 botoi poemën "Nga gjaku i tyre rrjedh liria"

Monografia dokumentare "Gafurr Loku 1949-1999" është vepra e tij e dytë.

Në dorëshkrim ka edhe punime të tjera.

Fragment nga romani "Kodra e Bajrakut" në dorëshkrim të autorit.

... Ora i ngjitej katërshit të mëngjesit dhe nuk ishte largë agu i ditës që po vinte. Kur arriti në Fushë të Thanave, papritmas, takoi tre njerëz të panjohur, të cilët posa e vërejtën, me të shpejtë ia rrotulluan pushkët.

- Kush je ti? - u dëgjua zëri i njeriut të parë, derisa dy të tjerët po e futnin në rreth udhëtarin e panjohur.

- Jam, unë, arkeologu dha një përgjegje të shterrur udhëtari, dhe kush e din se sa e sa mendime të shpejta kaluan nëpër kokën e tij e mbi të gjitha krisma e pushkës në Dardhani të Poshtme në mbrëmjen që kaloi.

Dy njerëzit e armatosur iu afruan udhëtarit dhe pushkët i mbanin në drejtim të tij. Pasi ia kontrolluan trupin me shpejtësi dhe vërejtën se udhëtari ishte i paarmatosur, e dërguan te i pari i tyre i cili nuk kishte lëvizur nga pozicioni dhe me të shpejt filluan t'ia kontrollonin çantën. Nxorën një libër të trashë, një brushë të butë, një metër formë rrumbullake, një fletore me shënime dhe një pjesë bukë, brenda me ca copa të vogla djathi.

- Kush jeni ju? - kumboi sërish zëri i njeriut të parë. Nga jeni dhe ku shkoni?

- Jam Arkeologu. Vi nga Dardhania e Poshtme dhe udhëtoj për në Dërrasë te një miku im.

- Ç'hall ke që udhëton natën dhe jo ditën?, e pyeti i armatosuri i dytë, derisa i treti po kontrollonte malin për rreth.

- Meqë duhet të takohem me një mik timin-siç iu thashë më parë dhe kam për të udhëtuar në një fshat tjetër, së bashku me atë. Për të kursyer kohën, vendosa që një pjesë të udhëtimit ta kaloj natën, gënjeu paq arkeologu.

- Po ky libër ç'është?, ndërhyri i armatosuri i parë.

- Është një libër mbi ilirët, siç e shihni edhe nga vetë emri, u përgjigj paksa i çliruar arkeologu duke krijuar një bindje se njerëzit e armatosur që takoi, nuk kishin të bënin me krismën e pushkës në Dardhani.

- Po kjo brushë, kjo metër, këto shënime ç'janë?, pyetën thuaja se njëzëri dy të armatosurit.

- Janë vegla pune, u përgjigj shkurt arkeologu.

- Me çfarë pune merreni zotëri?, ndërhyri i armatosuri i parë.

- Jam arkeolog dhe merrem me zbulime arkeologjike. Zbuloj nëntokën e Kosovës dhe pasi mori leje që nga xhepi i tij të nxjerr pakon e cigareve dhe pasi ua ndau nga një edhe njerëzve të armatosur, vazhdoi:

- Nëntoka e Kosovës fsheh thesare të çmueshme për historinë e popullit shqiptarë. Në dheun e kësaj toke janë rrënjët tona. Unë s'bëj gjë tjetër vetëm se këto gjurmë i nxjerrë në sipërfaqen e tokës së Kosovës që t'i shohim ne, t'i shohin të tjerët...

- Po ju kush jeni, nga vini dhe ç'bëni në këto male, madje me pushkë në duar?, pyeti disi i druajtur arkeologu.

- Edhe ne jemi si ju, u përgjigj i armatosuri i parë. Derisa ti, zotëri i nderuar, zbulon nëntokën e Kosovës, thesaret dhe rrënjët e saj, ne me armë në duar i mbrojmë këto vlera nga armiqtë e kombit tonë, të cilët, jo vetëm që dëshirojnë të na e zhdukin nëntokën, por dëshirojnë të na shfarosin edhe neve të gjallëve nga faqja e dheut.

Drita kishte marrë udhën e saj dhe arkeologu ndodhej sikur në një botë tjetër. Tani po i shihte edhe më mirë njerëzit e armatosur. Veshja e tyre modeste, fytyrat e parruara, armët dhe bombat e varura në rrypat e pantallonave, para syve të arkeologut shfaqën heronjtë kombëtarë të dekadave të kaluara dhe në vazhdim njerëzve të armatosur u tregoi fill e për pe gjithë ndodhinë dhe krismën enigmë të pushkës në Dardhani të Poshtme dhe pasi të pranishmit e dëgjuan me kujdes e lutën që edhe për një kohë të qëndronte me ata.

SHABAN ÇUPI


GAFURR LOKU
(1949 - 1999)
MONOGRAFI DOKUMENTARE

Redaktore teknike
Shemsie Lahu

Realizimi kompjuterik
ARS poetica
Ardiana Mehmeti - Bajrami

Shtypi
PROGRAF
Prishtinë
2003

"Derisa të jemi të coptuar, kurrë policët sllav s'kanë për t'u larguar nga shtëpitë tona. Derisa të jemi nën këmbën e maqedonit, malazezit dhe serbit, plagët tona kurrë s'do të shërohen, andaj vetëm bashkimi ynë kombëtar e territorial do të zgjidh një herë e përgjithmonë fatin tonë. Për këtë qëllim dhe për këtë ideal, jetën e dhanë dhe do ta japin kushe e din edhe sa e sa atdhetarë. Pa bashkim s'ka fuqi, pa bashkim s'ka liri".



GAFURR LOKU

"I robëruari nuk ka shumë dëshirà. Thellë në zemrën e tij frymon vetëm një dëshirë, që i robëruari dëshiron ta shohë, ta gëzojë, ta përjetojë dhe t'ua lë trashëgim pasardhësve. Ajo dëshirë është Liria. Kjo fjalë nuk ka shumë shkronja, por rrezet e saja ta ngrohin zemrën, të njomin shpirtin".